
$\varepsilon_{el} \rightarrow$ deformimet relative elastike

$\varepsilon_{sh} \rightarrow$ deformimet nga tkurrja (pa gjendje të sforcuar)

$\varepsilon_{bc} \rightarrow$ deformkoha bazë

$\varepsilon_{dc} \rightarrow$ deformkoha e thatë

$\varepsilon_{bc} + \varepsilon_{dc} = \varepsilon_{cc}(\infty, t_0) \rightarrow$ deformkoha totale

Formula baze që jep relacionin sforcim-deformim:

$$\{d\sigma\} = [D] \{\varepsilon\}$$

Ku $\{d\sigma\} \rightarrow$ vektori i ndryshimit të sforcimeve

$[D] \rightarrow$ matrica e ngurtësisë

$\{\varepsilon\} \rightarrow$ vektori i ndryshimit të deformimeve relative.

Në materialet homogjene matrica e ngurtësisë elastike ndryshon dhe është proporcionale me modulën e elasticitetit. Në materialet johomogjene matrica e ngurtësisë elastike ndryshon dhe nuk është e proporcionalë me modulën e elasticitetit.

Ndryshimi i ligjit sforcim-deformim relativ jepet me shprehjen: $\Delta\varepsilon = J \cdot \Delta\sigma + \Delta\varepsilon^0$

$\Delta\varepsilon \rightarrow$ vektori i ndryshimit të deformimeve ,

$\Delta\sigma \rightarrow$ vektori i ndryshimit të sforcimeve,

$J \rightarrow$ matrica katrore e inversit të ngurtësisë,

$\Delta\varepsilon^0 \rightarrow$ vektori i deformimet inelastike.

Metodat për llogaritjen e deformkohës.

Metoda e modulit efektiv.

Sipas kësaj metode relacioni midis sforcimeve dhe deformimeve jepet me shprehjen:

$$\varepsilon(t) = D \frac{1}{E_{eff}(t, t')} \sigma(t) + \varepsilon^0(t) \quad 2.3.2.$$

Ku t $\rightarrow$ momenti kohor kur bëhet vlerësimi i deformkohës.

t' $\rightarrow$ koha e përcaktimit të vlerës së modulit të elasticitetit.

D $\rightarrow$ matrica e ngurtësisë

$$E_{eff}(t, t') = \frac{1}{J(t, t')} = \frac{E(t')}{1 + \varphi(t, t')} \quad 2.3.3.$$

$E_{eff}(t, t') \rightarrow$ moduli efektiv i elasticitetit

$\varepsilon^0(t) \rightarrow$ deformimet inelastike

$J(t, t') \rightarrow$ funksioni që përfaqëson deformimet në momentin e kohës t (deformime elastike+deformkohën)

$$J(t, t') = \frac{1}{E(t')} + C(t, t') = \frac{1 + \varphi(t, t')}{E(t')} \quad 2.3.4.$$

$E(t') \rightarrow$ moduli i elasticitetit në momentin e kohës t' .

$\varphi(t, t') \rightarrow$ koeficienti i deformkohës që përfaqëson raportin e deformimit nga deformkoha me deformacionin elastik.

$$\varphi(t, t') = E(t')J(t, t') - 1 \quad 2.3.5.$$

$$C(t, t') = \frac{\varphi(t, t')}{E(t')} = \frac{\varepsilon_c}{\varepsilon_{inst}} \frac{1}{E(t')} = \frac{\varepsilon_c}{\sigma} \quad 2.3.6.$$

Ku $C(t, t')$ quhet funksioni specifik i deformkohës.

Kjo metodë përcakton rritjen e deformimeve relative në një sistem struktural në intervalin kohor midis t_0 dhe t kur ngarkimi i strukturës është bërë në momentin e kohës t_0 .

$$\Delta\varepsilon(t) = D \left[\frac{1}{E_{eff}} \Delta\sigma(t) + \frac{\sigma(t_0)}{E(t_0)} \varphi(t, t_0) \right] + \Delta\varepsilon^0(t) \quad 2.3.7.$$

Ku $\Delta\sigma(t) \rightarrow$ zmadhimi i sforcimeve në momentin t .

$\Delta\varepsilon^0(t) \rightarrow$ zmadhimi i deformimeve relative inelastike në momentin t .

$t_0 \rightarrow$ momenti i ngarkimit të parë.

Metoda e modulit efektiv jep rezultate të sakta kur sforcimet janë konstante (të pandryshuara) në intervalin e kohës t_0 deri në momentin kohor t' .

• Metoda e variacionit linear

Supozojmë se deri në momentin e kohës t_0 diferenca midis deformimeve $\varepsilon - \varepsilon^0$ është zero dhe në momentin kohor t_0 kjo diferencë ndryshon menjëherë me vlerën a . Duke aplikuar ligjin linear të ndryshimit të deformimeve relative në

intervalin e kohës nga t_0 në një moment t deformimet relative përcaktohen me shprehjen e mëposhtme:

$$\varepsilon(t) - \varepsilon_0(t) = a + c\varphi(t - t_0) \quad 2.3.8.$$

Sforcimet për $t_0 > t$ janë:

$$\sigma(t) = (a - c)R(t, t_0) + cE(t_0) \quad 2.3.9.$$

Ku a, c janë konstante.

Nga llogaritjet algjebrike duke iu referuar marëdhënies sforcim-deformim mund të përcaktohet moduli i elasticitetit efektiv në momentin e kohës t duke ju referuar metodës së modulit efektiv të korrigjuar me koeficientin e deformkohës.

$$E''(t, t_0) = \frac{E(t_0)}{1 + \chi\varphi(t, t_0)} \quad 2.3.10.$$

Ku $\chi \rightarrow$ koeficienti i relaksimit (koeficient që varet nga mosha e betonit) ku $\chi = (0.5 \div 1.0)$

Dhe ndryshimi i deformimeve relative është:

$$\Delta\varepsilon = \varepsilon(t) - \varepsilon_0(t) \quad 2.3.11.$$

$$\varepsilon(t) = \frac{1}{E''(t, t_0)} D\Delta\sigma(t) + \Delta\varepsilon''(t) \quad 2.3.12.$$

$$\varepsilon''(t) = \frac{\varphi(t, t_0)}{E''(t, t_0)} D\Delta\sigma(t_0) + \Delta\varepsilon^0(t) \quad 2.3.13.$$

• **Hipotezat bazë për llogaritjen e deformimeve nga deformkoha**

a) Kurba e deformimeve që zhvillohet për një kohë të shkurort mund të përdoret edhe për parashikimet e zhvillimit të deformimeve afatgjatë, referuar rezultateve eksperimentale sipas Prof. Oral Buyukozturk.

b) Kur të dhënat eksperimentale mungojnë llogaritja e deformkohës bëhet bazuar në kushtet e projektimit.

c) Koeficienti i deformkohës $\varphi(t - t_0)$ në momentin t të moshës së betonit ndikohet nga konditat e ngurtësimit të betonit, përmasat gjeometrike të elementit, përberja e betonit dhe është në varësi të diferencës së kohës së

marrë në konsideratë ($t-t_0$) ku t është mosha aktuale e betonit në momentin e llogaritjes dhe t_0 është mosha e betonit kur elementi ngarkohet për herë të parë.

d) Principi i superpozimit bazohet në faktin se për qellime projektimi varësia sforcim-deformkohë mund të shkruhet sipas formulës 2.3.14.

$$\varepsilon_{cr} = f_0 \varepsilon_{sp}(t, \tau) + \sum_{i=\tau}^t [\Delta F(\tau_i) \varepsilon_{sp}(t, \tau_i)] \quad 2.3.14.$$

Ku $f_0 \rightarrow$ janë sforcimet në beton në momentin e ngarkimit të parë në kohën t_0 .

$\varepsilon_{sp}(t, \tau) \rightarrow$ deformimet specifike të deformkohës për betonet e ngarkuara në momentin e kohës τ_i .

$\Delta F(\tau_i) \rightarrow$ shtesa e sforcimeve të aplikuara në momentin e kohës τ_i , ku $\tau < \tau_i < t$.

$\varepsilon_{sp}(t, \tau_i) \rightarrow$ deformimet specifike të deformkohës në momentin e kohës t për betonin e moshës $\tau_i > t$.

e) Efekti i sforcimeve në vlerën e deformkohës llogaritet me metodën e superpozimit.

f) Deformimet e deformkohës në beton në momentin kohor t të shkaktuara nga veprimi i një force të aplikuar në momentin e kohës τ janë të pavarura nga ndikimi i ndonjë gjendjeje tjetër të sforcuar më herët ose më vonë se momenti i kohës τ .

g) Deformkoha është një fenomen edhe në rastin e një elementi që punon në tërheqje.

i) Deformkoha nën ndikimin e një gjendjeje të sforcuar të ndryshueshme varet nga kurba e ndryshimit të sforcimeve dhe ndryshon në intervale të ndryshme kohore të marra në konsideratë.

Deformkoha e betonit në elementë me gjendje të sforcuar të ndryshueshme.

- Deformkoha ndikon në elementët që punojnë në tërheqje si edhe në shtypje. Madhësia e deformkohës në tërheqje është shumë më e madhe se në shtypje.
- Deformkoha e betonit ndodh edhe nën veprimin e ngarkesave që shkaktojnë përdredhje.
- Në shtypjen një aksiale deformkoha ndodh jo vetëm në drejtimin aksial të veprimit të ngarkesës por edhe në drejtimet normale me aksin.
- Në elementët që ndodhen nën veprimin e ngarkesave multiaksiale deformkoha ndodh në të gjitha drejtimet dhe ndikohet nga sforcimet normale të drejtimeve të tjera.

2.4. Faktorët që influencojnë në deformkohën e betonit.

Faktorët që influencojnë në fenomenin e deformkohës ndahen në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

a) Faktorët e brendshëm kanë të bëjnë me përbërjen e betonit. Këtu hyjnë:

- Lloji i agregateve dhe përmbajtja në përbërjen e betonit. Rritja në përmbajtje e tyre sjell zvogëlim të deformkohës.
- Raporti uje/çimento. Rritja e raportit uje/çimento ndikon në rritjen e deformkohës.
- Ngurtësia e agregateve në përbërje të betonit. Sa më e madhe të jetë ngurtësia e agregateve aq më e vogël do të jetë deformkoha.
- Klasa dhe vetitë e çimentos ndikojnë në madhësinë e deformkohës.
- Moduli i elasticitetit të betonit.
- Poroziteti.

b) Faktorët e jashtëm dhe konditat ambientale:

- Madhësia e elementit.
- Forma e elementit.
- Sipërfaqja e prerjes tërthore.
- Raporti i sipërfaqes anësore të ekspozuar të elementit me vëllimin.
- Faktorët ambientale. (Temperatura dhe lagështia relative e ambientit).
- Madhësia e sforcimeve në element nga forcat e jashtme.
- Mënyra e trajtimit të betonit gjatë procesit të hedhjes në vepër dhe procesit të ngurtësimit të betonit.
- Momenti i ngarkimit të elementit.
- Kohëzgjatja e ngarkesës.

Shkak i deformkohës mund të jenë një ose disa kombinime të faktorëve të mëposhtëm:

- Përmbajtja e ujit të absorbuar në beton.
- Dalja jashtë e ujit gjatë procesit të ngurtësimit.
- Deformimet elastike të betonit.
- Frakturat ose thyerjet lokale të skeletit dhe mikro plasaritjet.

Moduli i elasticitetit të betonit ndryshon në funksion të gjendjes së sforcuar. Ka disa faktorë që ndikojnë ku një nga më të rëndësishmit është raporti uje/çimento. Rritja e raportit uje/çimento zvogëlon modulin e elasticitetit.

Refruar (Fintal, Ghosh, Iyengar, 1987) Fig. 2.4.1.paraqet ndikimin e agregateve, dhe pastës së çimentos në variacionin e sforcimeve nga deformimeve relative të betonit.




Fig.2.4.1. Ndikimi i përmbajtjes së agregateve dhe pastës së çimentos në sjelljen e betonit. Fintal, Ghosh, Iyengar, (1987)

Në varësi të llojit të agregateve të përdorur në përbërjen e betonit vërehet që ndikimi i tyre në madhësinë e deformkohës mund të shprehet nëpërmjet grafikut në Fig. 2.4.2. ku jepet varësia e deformkohës nga moduli i elasticitetit të betonit që ka në përbërje agregate sipas klasifikimit. Moduli i elasticitetit të betonit shërben si mbërthim në deformimet e materialit. Zmadhimi i modulit të elasticitetit redukton deformkohën. Po kështu, përmbajtja e lartë e agregateve në beton redukton deformkohën sepse deformkoha nuk ka shkak agregatet por pastën e çimentos.




Fig.2.4.2. Ndikimi i tipit të agregateve në vlerën e modulit të elasticitetit




Fig.2.4.3. Ndikimi i agregateve në deformkohën e betonit në funksion të modilit të elasticitetit të betonit.




Fig.2.4.4. Skematikisht faktorët që ndikojnë në deformkohën e betonit .

2.5. Llogaritja e deformkohës sipas EC 2.

Burrimi i deformkohës dhe tkurrjes së betonit është pasta e çimentos e hidratuar. Faktorët që influencojnë në tkurrjen e betonit janë gjithashtu influencuar edhe në deformkohën e betonit. Madhësia e deformimeve nga deformkoha dhe tkurrja nuk mund të neglizhohen në llogaritjet e strukturave prej betoni të armuar. Ndikimi i tyre duhet të merret në llogaritje për verifikimin e gjendjes së shërbimit ose shfrytëzimit.

Ndikimi i tkurrjes dhe deformkohës duhet të konsiderohet në llogaritje në aftësi mbajtëse vetëm kur efektet e tyre janë përcaktuese në qendrueshmërinë e strukturës. Për shembull duhet të verifikohet gjendja kufitare limite e stabilitetit në ato elementë ku efektet e rendit të dytë ose sekondare përcaktojnë qendrueshmërinë e strukturës.

Në rastet kur deformkoha merret në llogaritje kombinimi i ngarkesave do të bëhet referuar situatës afatgjatë të veprimit të tyre.

Në rastet kur tkurrja merret në konsideratë në llogaritjen e elementit kombinimi i ngarkesave në gjendjen kufitare të fundme shumëzohet me një koeficient γ_{SH} . Ky koeficient përcaktohet në anekset kombëtare e nëse vlera e tij nuk gjendet në anekset kombëtare $\gamma_{SH} = 1.0$. (EC2_dec.04, 2.4.2.2)

Deformkoha dhe tkurrja e betonit varen nga lagështia ambjentale, dimensionet e elementit dhe përbërja e betonit. Deformkoha gjithashtu influencohet edhe nga momenti i parë kur aplikohet ngarkesa, zgjatja dhe magnituta e ngarkimit.

Deformimet totale të elementit mund të shprehen si shumë:

$$\varepsilon_c(t) = \varepsilon_{el} + \varepsilon_{sh} + (\varepsilon_{bc} + \varepsilon_{dc}) \quad 2.5.1.$$

$\varepsilon_c(t) \rightarrow$ deformimet totale të betonit në momentin e kohës t .

$\varepsilon_{el} \rightarrow$ deformimet elastike.

$\varepsilon_{sh} \rightarrow$ deformimet nga tkurrja (pa gjendje të sforcuar).

$\varepsilon_{bc} \rightarrow$ deformimet nga deformkoha bazë.

$\varepsilon_{dc} \rightarrow$ deformimet nga deformkoha e thatë.

$\varepsilon_{bc} + \varepsilon_{dc} = \varepsilon_{cc}(\infty, t_0) \rightarrow$ deformimet totale të deformkohës.

Koeficienti i deformkohës së betonit në momentin e kohës t referuar deformacionit elastik në moshën t_0 sipas EC2_dec_2004 është $\varphi(t, t_0)$ dhe përcaktohet në varësi të modulit të elasticitetit E_c , ku:

$$E_c = 1.05 E_{cm}. \quad 2.5.2.$$

Ku $E_{cm} \rightarrow$ Moduli i elasticitetit përcaktuar nga sekantja që ndryshe mund të quhet moduli i mesatarizuar i elasticitetit.

Me saktësi të mjaftueshme, në moshën t_0 të betonit, sforcimet janë $\sigma_c < 0.45 f_{ck}(t_0)$.

Deformimet nga deformkoha në beton $\varepsilon_{cc}(\infty, t_0)$ në momentin $t = \infty$ për sforcime konstante shtypëse në moshën e betonit t_0 janë:

$$\varepsilon_{cc}(\infty, t_0) = \varphi(\infty, t_0) \cdot (\sigma_c / E_c) \quad 2.5.3.$$

Kur sforcimet janë $\sigma_c > 0.45 f_{ck}(t_0)$ atëhere duhet të konsiderohet në llogaritje deformkoha jo lineare e betonit.

Në Eurocode 2 janë dhënë disa grafikë për llogaritjen e koeficientit të deformkohës për elementë në kondita ambientale të brendshme kur lagështia relative $RH=50\%$ dhe të jashtme kur $RH=80\%$ për seksione me lartësi h_0 .

Për llogaritjen e koeficientit të deformkohës sipas EC vlerat e temperaturës ambientale janë konsideruar brenda kufijve -40°C dhe $+40^{\circ}\text{C}$ and lagështia relative ambientale është brenda kufijve $RH=40\%$ dhe $RH=100\%$.




Fig.2.5.1. Përcaktimi i i koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$, $RH=50\%$ [Ambjenti i brendshëm]




Fig.2.5.2. Përcaktimi i i koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$, $RH=80\%$ [Ambjenti i jashtëm]




Fig.2.5.3. Përcaktimi i koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ sipas grafikëve të Fig.2.5.1., Fig.2.5.2.

$\varphi(\infty, t_0) \rightarrow$ është koeficienti final i deformkohës

$t_0 \rightarrow$ është mosha në ditë e betonit në momentin e ngarkimit.

$h_0 = 2A_c/u$, ku A_c është sipërfaqja e prerjes tërthore të betonit dhe u është perimetri i ekspozuar në ambjentin e jashtëm.

$S \rightarrow$ është klasa S e çimentos sipas EC2_dec_2004, për çimento tipi CEM 32.5N.

$N \rightarrow$ është klasa N e çimentos për çimento tipi CEM 32.5 R, CEM 42.5 N.

$R \rightarrow$ është klasa R e çimentos për çimento tipi CEM 42.5 R, CEM 52.5 N dhe CEM 52.5R.

Koeficienti i deformkohës $\varphi(t, t_0)$ paraqet koeficientin e deformkohës në intervalin kohor t dhe t_0 , referuar deformimeve elastike në moshën 28 ditore e llogaritet:

$$\varphi(t, t_0) = \varphi_0 \cdot \beta_c(t, t_0) \quad 2.5.4.$$

ku:

$$\varphi_0 = \varphi_{RH} \cdot \beta(f_{cm}) \cdot \beta(t_0) \quad 2.5.5.$$

$t_0 \rightarrow$ mosha e betonit në momentin e ngarkimit.

$\varphi_{RH} = f(RH) \rightarrow$ funksion që varet nga lagështia relative ambjentale.

$RH \rightarrow$ lagështia relative ambjentale në %.

$$\varphi_{RH} = \begin{cases} 1 + \left[\frac{1 - \frac{RH}{100}}{0.1 \cdot \sqrt[3]{h}} \right] & \text{for } f_{cm} < 35 \text{ MPa} \\ 1 + \left[\frac{1 - \frac{RH}{100}}{0.1 \cdot \sqrt[3]{h}} \cdot \alpha_1 \right] \cdot \alpha_2 & \text{for } f_{cm} < 35 \text{ MPa} \end{cases} \quad 2.5.6.$$

$$\beta(f_{cm}) = 16.8 / \sqrt[3]{f_{cm}} \quad 2.5.7.$$

$f_{cm} \rightarrow$ është rezistenca në shtypje e betonit në moshën 28 ditore.

$\beta(t_0)$ është një koeficient që merr në llogaritje ndikimin e moshës së betonit në momentin e ngarkimit dhe llogaritet:

$$\beta(t_0) = \frac{1}{(0.1 + t_0^{0.20})} \quad 2.5.8.$$

h varet nga përmasat gjeometrike të sëksionit dhe përcaktohet në mm:

$$h = \frac{2A_c}{u} \quad 2.5.9.$$

A_c → është sipërfaqja e prerjes tërthore të elementit.

u → është perimetri i elementit të ekspozuar në atmosferë.

$\beta_c(t, t_0)$ → është një koeficient që paraqit zhvillimin e deformkohës për periudhën pas ngarkimit të elementit dhe mund të jepet me shprehjen:

$$\beta_c(t, t_0) = \left[\frac{(t - t_0)}{\beta_H + t - t_0} \right]^{-0.3} \quad 2.5.10$$

t → është mosha e betonit në ditë në momentin e marrë në konsideratë.

t_0 → është mosha e betonit në momentin e ngarkimit.

$t-t_0$ → është kohëzgjatja në ditë e periudhës së marrë në shqyrtim.

β_H → është koeficient që varet nga lagështia relative RH në % .

$$\beta_H = 1.5[1 + (0.012RH)^{18}]h_0 + 250 \leq 1500 \quad \text{për} \quad f_{cm} \leq 35 \quad 2.5.11.$$

$$\beta_H = 1.5[1 + (0.012RH)^{18}]h_0 + 250\alpha_3 \leq 1500\alpha_3 \quad \text{për} \quad f_{cm} > 35 \quad 2.5.12.$$

$\alpha_1, \alpha_2, \alpha_3$ janë koeficientë që marrin në konsideratë influencën e rezistencës së betonit dhe llogariten:

$$\alpha_1 = [35/f_{cm}]^{0.7}; \quad \alpha_2 = [35/f_{cm}]^{0.2}; \quad \alpha_3 = [35/f_{cm}]^{0.5}$$

Ndikimi i klasës së çimentos në deformkohën e betonit mund të konsiderohet në llogaritje nëpërmjet modifikimit të moshës së ngarkimit t_0 në shprehjen:

$$\beta(t_0) = 1/(0.1 + t_0^{0.20}) \quad 2.5.13.$$

Ku momenti i ngarkimit jepet nëpërmjet shprehjes:

$$t_0 = t_{0,T} \cdot \left(\frac{9}{2 + t_{0,T}^{1.2}} + 1 \right)^\alpha > 0.5 \quad 2.5.14.$$

Ku $t_{0,T}$ është temperatura e betonit në momentin e ngarkimit

α është fuqia që varet nga tipi i çimentos së përdorur në beton dhe merr vlerat:

$\alpha = -1$ për klasën S të çimentos.

$\alpha = 0$ për klasën N të çimentos.

$\alpha = 1$ për klasën R të çimentos.

Efekti i reduktimit të temperaturës në diapazonin 0-80°C merret në llogaritje sipas shprehjes:

$$t_T = \sum_{i=1}^n e^{-(-4000/[(273+T(\Delta t_i)]-13.65)} \cdot \Delta t_i \quad 2.5.15.$$

t_T është temperature e betonit në momentin T .

$T(\Delta t_i)$ është temperatura në $^{\circ}\text{C}$ gjatë periudhës Δt_i

Δt_i është numuri i ditëve me temperaturë T .

Vlera e koeficientit të deformkohës $\varphi(t, t_0)$ jepet referuar modulit tangent të elasticitetit E_c .

3. Tkurrja dhe bymimi i betonit.

3.1. Tkurrja dhe klasifikimi i tkurrjes së betonit.

Tkurrja dhe bymimi i betonit i referohet ndryshimit gradual të vëllimit të betonit që nuk ka si shkak gjendjen e brendshme të sforcuar. Shkaqet e tkurrjes janë:

- a) Humbja e ujit nga procesi i tharjes.
- b) Ndryshimim i volumit nga karbonatizimi i betonit.

Në fazën e hershme të betonit ndryshimet në vëllim nuk merren parasysh në llogaritjen konstruktive të elementëve. Tkurrja mund të klasifikohet sipas moshës së betonit në tkurrjen e hershme që ndodh brenda 24 orëve të para të hedhjes në vepër të betonit dhe tkurrje e vonshme pas 24 orëve të para.

Tkurrja e betonit është procesi i zvogëlimit të vëllimit të betonit që ndodh për shkak të procesit të hidratimit me humbje të ujit nga avullimi. Avullimi ndodh që në fazën plastike të betonit e më pas në fazën e ngurtësuar.

Tkurrja ndodh për shkak të rritjes së presionit sipërfaqesor dhe tensionit kapilar gjatë procesit të tharjes si edhe nga rënia e presionit të lidhjeve kristalore në pastën e çimentos.

Tkurrja e betonit matet nëpërmjet monitorimit të deformimeve të betonit në mostra standarte. Tkurrja e betonit mund të klasifikohet në bazë të shkaqeve që ndikojnë në ndryshimin e vëllimit të betonit në:

- a) Tkurrja plastike është fenomen me origjinë fizike në fazën plastike të betonit.
- b) Tkurrja autogenoze është fenomen me origjinë fizike e shkaktuar nga reaksionet kimike.
- c) Tkurrja e thatë dhe bymimi është fenomen me origjinë fizike.

d) Tkurrja karbonatike është fenomen që ka origjinë reaksionet kimike.

Tkurrja e hershme klasifikohet si autogenoze, e thatë dhe termale. Tkurrja e vonshme është rezultat i karbonatizimit, veprimeve termale, kimike ose autogenoze. Këto fenomene kanë magnituta (madhësi) të ndryshme dhe zhvillohen në kohë të ndryshme. Në mostrat e pambërthyerat tkurrja është një fenomen që zhvillohet plotësisht ku elementi i betonit është i pangarkuar, me sforcime zero. Në mostrat e mbërthyerat tkurrja shkakton sforcime makroskopike në elemente si p.sh. trarët me mbështetje të fiksuara.

Tkurrja plastike është ndryshimi i vëllimit të betonit për shkak të humbjes së ujit nga avullimi që ndodh në betonin e freskët në gjendje plastike. Ka si origjinë daljen e ujit në sipërfaqe, varet nga konditat ambjentale si lagështia relative ambjentale, shpejtësia e erës dhe temperatura e mjedisit përreth. Ndikim të konsiderueshëm ka përmbajtja e çimentos dhe mbushësit ose agregatit të hollë, raporti ujë/çimento dhe poroziteti. Tkurrja plastike mund të jetë shkak i plasaritjeve të konsiderueshme në sipërfaqe të elementit dhe varet nga sasia e ujit të avulluar që mund të konsiderohet në vlera maksimale edhe deri në 1kg/m^2 sipërfaqe e ekspozuar. Menisket e formuara gjenerojnë presion kapilar negativ që shkakton reduktim të volumit në pastën e çimentos. Tkurrja termale mund të zhvillohet në fazën e hershme të moshës së betonit pasi temperatura ngrihet gjatë procesit të ngurtësimit.

Ndryshimet jo uniforme të vëllimit krijojnë sforcime në beton të cilat mund të shkaktojnë formimin e plasaritjeve në betonin plastik. Këto tipe të plasaritjeve shfaqen gjatë orëve të para pas hedhjes së betonit në vepër, kanë shpërndarje të çrregullt dhe janë të cekta e sipërfaqësore. Uji ndahet nga betoni për shkak të peshës gravitacionale dhe ka tendencë të dalë në sipërfaqe dhe në disa raste duket sikur rrjedh e shoqërohet me plasaritje në elementin konstruktiv.



Fig.3.1.1. Skema e ndarjes së ujit nga betoni në tkurrjen plastike, plasaritjet sipërfaqësore nga ndikimi i tkurrjes plastike.

Tkurrja autogenoze ose tkurrja kimike është reduktim i përmasave të elementit në temperaturë konstante, pa ndryshim të lagështisë në beton ose pa humbje të lagështisë në ambjentin përreth.

Gjatë reaksionit të hidratimit të çimentos së pahidratuar me ujin krijohen hidratat i silikatit të kalciumit C-H-S, hidroksid kalciumi dhe nxehtësi. Produkti i hidratimit ka vëllim më të vogël se shumica e vëllimeve të reaktantëve fillestare dhe ndryshimi i vëllimit ka si shkak tkurrjen kimike.



Materiali plastik ngurtësohet, reaksionet kimike ndryshojnë gjendjen fizike të betonit dhe procesi rezulton në zbrazjen e poreve kapilare dhe rënien e lagështisë relative (ndonjëherë quhet edhe tkurrje e thatë e brendshme) gjë që stimulon rritjen e forcave kapilare. Këto forca shkaktojnë kontraktim të materialit dhe tkurrja autogenoze ndodh vetëm në betonin në gjendje plastike pa transferim të lagështisë. Në strukturat masive tkurrja autogenoze mund të zhvillohet edhe brenda elementit në vijim e shoqëruar me çlirim nxehtësie të brendshme dhe rritje të temperaturës.

Vlerat e tkurrjes autogenoze për raporte ujë/çimento >0.4 mund të neglizhohen krahasuar me tkurrjen e thatë pasi shkojnë në madhësi të përafërt deri në 40×10^{-6} . Rënia e vlerës së lagështisë relative të poreve quhet vetë-dehidratim i betonit. Lagështia relative në betonet e zakonshëm është (92-98)%. Në betonet e klasave të larta me raport ujë/çimento të ulët tkurrja autogenoze nuk mund të neglizhohet. Në këto tipe betonesh lagështia relative e poreve shkon në masën deri 70%.

Në kushtet e projektimit tkurrja autogenoze trajtohet në strukturat masive ku ndikimi i saj është i konsiderueshëm dhe trajtimi shpesh është i domosdoshëm. [Neville 1995].





Fig. 3.1.2. Tkurrja autogenoze (kimike) plasaritje me shkak tkurrjen autogenoze në beton.

Tkurrja karbonatike është rezultat i dy reaksioneve kimike të veprimit të CO_2 në ajër me $\text{Ca}(\text{OH})_2$ sipas reaksionit kimit të bashkëveprimit:



Në sipërfaqet e sforcuara acidi karbonatik vepron me hidroksidin e kalciumit që ka si rezultat krijimin e karbonatit të kalciumit i cili depozitohet në hapësirat e pa sforcuara.



CaCO_3 ka vëllim më të vogël se $\text{Ca}(\text{OH})_2$

Ky reaksion varet nga lagështia relative dhe ka shkallën më të lartë për lagështi të rendit 50-55% ndërsa për saturim 0% ose 100% reaksioni nuk ndodh. Nëpërmjet reaksionit të karbonatizimit ka rritje të masës për shkak të dioksidit të karbonit të absorbuar në elementin e betonit ndërsa gjatë tkurrjes së thatë ndodh e kundërta kemi humbje të masës. Kur këto dy fenomene ndodhin njëkohësisht kështu ndryshimi i masës është i vogël. Tkurrja karbonatike nuk trajtohet në kushtet teknike të projektimit.




Fig.3.1.3. Karbonatizimi i betonit i kombinuar me veprimin e klorideve

Tkurrja e thatë ndodh në betonin e ngurtësuar dhe përcaktohet si tkurrje nga largimi i ujit kapilar. Kjo tkurrje shkaktohet nën ndikimin e gjendjes së sforcuar e cila mund të shkaktojë plasaritje, dëmtim të brendshëm të skeletit, deformim të elementit përpara se elementi të jetë subjekt i një ngarkimi. Zakonisht fillon pas 6 muajsh të hedhjes së betonit në vepër dhe është një nga arsyet kryesore të plasaritjeve në strukturat e holla. Tkurrja e thatë ndodh në soleta, trarë, kolona, mure mbajtës, elementë të paranderur, rezervuarë, themele etj.

Fenomeni i tkurrjes së thatë është vlerësuar përpara deformkohës. Gjatë procesit të tharjes së betonit së pari uji i lirë nga kavitetet dhe poret e mëdha del jashtë. Ky fenomen çon në humbje të peshës me deformime shumë të vogla, të pandjeshme. Gjatë vazhdimit të procesit të tharjes uji i absorbuar nga poret kapilare lëviz e sjell rritje të tensionit kapilar dhe shakton tkurrje të pastës së hidratuar të çimentos. Tharja fillon në sipërfaqen e ekspozuar të elementit prej betoni. Korja e jashtme e elementit fillon të thahet e shpejtësia e tharjes varet nga madhësia, forma e elementit dhe difuziviteti i betonit. Tharja e diferencuar shkakton tkurrje të diferencuar që shkakton shpërndarje jo uniforme të

sforcimeve dhe plasaritje sipërfaqësore nëse sforcimet janë më të mëdha se rezistenca e betonit në tërheqje. Tkurrja e thatë nuk është plotësisht e kthyeshme pas procesit të rilagies pasi krijohen fraktura në mikrostrukturën e betonit.

Magnituta e tkurrjes së thatë varet nga shumë faktorë si: lagështia relative ambjentale, sasia e ujit, lloji i çimentos së përdorur dhe raporti ujë/çimento, madhësia, përbërja dhe lloji i agregateve, aditivët dhe përmasat e elementit. Magnituta e tkurrjes së thatë ndikohet nga sasia e ujit të humbur gjë që sjell rritjen e saj me uljen e lagështisë relative ambjentale. Në rastet kur raporti ujë/çimento rritet, magnituta e tkurrjes së thatë rritet. Përmbajtja e lartë e agregateve me përmasa të mëdha ndikon në uljen e tkurrjes së thatë pasi agregatet shërbejnë si mbërthyes në procesin e tkurrjes së materialit. Tipi i çimentos së përdorur në prodhimin e betonit ndikon në vlerat e tkurrjes së thatë.

Procesi i tkurrjes së thatë është i ngadalshëm dhe sforcimet vetë-ekuilibruese të cilat shkaktohen nga tkurrja e diferencuar relaksojnë procesin e deformkohës ku magnituta finale e tkurrjes së thatë zvogëlohet.

Tkurrja e elementit të betonit varet nga përmasat dhe forma e elementit konstruktiv dhe mënyra e ngurtësimit të betonit. Nëse një mostër betoni do t'i nenshtrohet procesit të tharrjes në autoklavë (tharje me presion avulli) rezulton me reduktim të tkurrjes në masën deri 1/6-1/3 e tkurrjes me ngurtësim normal të betonit.




Fig.3.1.4. Tkurrja autogenoze dhe tkurrja e thatë për raporte të ndryshme w/c në funksion të lagështisë ambjentale në %

3.2. Bymimi i betonit.

Bymimi është procesi i zmadhimit të vëllimit të elementit të betonit që vjen si rezultat i shtimit të ujit artificialisht ose në varësi të konditave ambjentale me lagështi relative 100%.

Kur mostra e betonit zhytet në ujë, uji gradualisht fillon dhe mbush poret e hapura, poret kapilare dhe redukton presionin kapilar dhe presionin në skelet dhe mund të shkaktojë edhe reaksione kimike shtesë e shoqerohet me rritje të masës së elementit. Bymimi varet jo vetëm nga lagështia ambjentale por edhe nga temperatura. Ka dy arsye pse bymimin e neglizhojmë në elementët e betonit:

- a) Sforcimet e shkaktuara nga bymimi janë relativisht të vogla.
- b) Sforcimet e shkaktuara nga bymimi janë shtypëse dhe jo tërheqëse si në procesin e tkurrjes.

3.3. Faktorët që influencojnë në tkurrjen e betonit.

Faktorët që influencojnë në tkurrjen e betonit janë:

1. Lloji, përberja mineralogjike dhe madhësia e agregateve.
2. Klasa e çimentos së përdorur.
3. Rraporti ujë/çimento.
4. Dimensionet e elementit dhe raporti vëllim/sipërfaqe e ekspozuar në ambjentin e jashtëm.
5. Poroziteti.
6. Lagështia ambjentale dhe temperatura mesatare ambjentale.




Fig.3.3.1. Skematikisht faktorët që ndikojnë në tkurrjen e betonit .

3.4. Mekanizmi i tkurrjes

Mekanizmi i tkurrjes mund të klasifikohet si më poshtë:

1. Është një fenomen që ka të bëjë me absorbimin e ujit të poreve si deformkoha.
2. Lidhet me lëvizjen e ujit të poreve në pastën e çimentos me rezultat reduktimin e vëllimit të pastës së çimentos për shkak të kapilaritetit të hidratit të silikatit të kalciumit C-S-H.
3. Teoria e tensionit kapilar. Tensioni kapilar shkakton zmadhimin e kurbaturës së meniskit, kur uji del jashtë elementit kurbatura e meniskit $1/r$ zmadhohet e rezja e kurbaturës r zvogëlohet duke shkaktuar tension shtypës në skeletin e ngurtësuar me rezultat ndryshimin e vëllimit..
4. Teoria e ndryshimit të energjisë sipërfaqësore. Me daljen e ujit nga sipërfaqja e ekspozuar e elementit ka reduktim të energjisë në pastën e çimentos C-H-S gjatë lëvizjes së molekulave të ujit me pasojë reduktimin e vëllimit të betonit.
5. Teoria e reduktimit të presionit nga lëvizja e ujit të poreve. Kjo teori pranon që lëvizja e ujit të poreve në betonin e ngurtësuar shkakton reduktim të presionit të brendshëm që shoqërohet me reduktim të vëllimit të betonit.
6. Gjatë procesit të tkurrjes ndodh kalimi i ujit nga gjendja e lëngët në të gaztë. Kur aplikohet presion në lëng molekulat e ujit ngjishen dhe tentojnë të largohen duke filluar gradualisht që uji të kthehet në gjendje të gaztë. Kur vendoset ekuilibri, potencialet e ekuilibrit kimik të lëngut dhe avullit janë të barabarta. Nëse ndryshon presioni ky ekuilibër prishet. Gjatë avullimit poret më të mëdha në fillim e më pas të tjerat gradualisht fillojnë të zbrazen derisa bëhen plotësisht të thata. Uji ka tendencë të shpërndalet përgjate drejtimeve të forcave kapilare e të rrisë sipërfaqen nën tension e rezja e meniskit ka tendencë të rritet. Tensioni maksimal është në fund të meniskit dhe gradualisht reduktohet e uji tenton të dalë jashtë ose të shpërndalet. Prandaj ka tension shtypës në skeletin e ngurtë dhe tkurrje. Shtypja ndodh në skeletin e pastës së çimentos.
7. Nëse raporti ujë/çimento është i vogël në vlera tkurrja autogenoze mund të jetë në magnitudën e saj më e madhe se tkurrja e thatë. Kjo ndodh në mostrat e mbyllura për shkak të krijimit të poreve bosh gjatë procesit të krijimit të skeletit.
8. Në betonet e klasave të larta ku raporti ujë/çimento është i vogël tkurrja autogenoze ngjason me tkurrjen e thatë. Kjo nënkupton që në betonet e klasave të larta me raport ujë/çimento të ulët tkurrja autogenoze shkon drejt trajtimit si tkurrje e thatë.




Fig. 3.4.1. Skemë e idealizuar e ujit të absorbuar, levizja e ujit në makroporet, presioni në skeletin e ngurtë dhe ujin e poreve.

9. Kur raporti ujë/çimento është në vlera të larta gjatë procesit të ngurtësimit krijohen pore të depërtueshme. Avullimi i ujit mund të jetë më i madh se në betonet e zakonshme. Tharrja do të rezultojë me krijimin e poreve të reja bosh e kjo gjendje shkakton tkurrje jo uniforme.

10. Gjatë procesit të tkurrjes ndodh zvogëlimi i vëllimit të pastës së çimentos që kundërshtohet nga agregatet ose mbushësit e betonit. Ky kundërshtim varet nga vlera e moduli të elasticitetit të mbushësit. Sa më i madh të jetë moduli i elasticitetit të agregateve aq më e vogël është tkurrja e betonit.




Fig.3.4.2. Funkzioni i tkurrjes relative në 10^{-6} nga vëllimi në përmbajtje në % të agregateve

Referuar grafikut të mesipërm të Fig.3.4.2. vërehet se sa më e madhe të jetë përmbajtja e agregateve në beton aq më e vogël është tkurrja.

Rritja e raportit ujë/çimento zmadhon tkurrjen. Mesatarisht pasta e çimentos është në përbërje çimento+ujë në raportet 1 dhe 3.15, ose vëllimi i pastës së çimentos mund të jepet:

$$\frac{w}{1} + \frac{c}{3.15}$$

Vëllim uji + vëllim çimento = vëllimi i pastës së çimentos

Sa më i madh të jetë vëllimi i pastës së çimentos aq më e madhe do të jetë magnituda e tkurrjes, pasi është pasta e çimentos materiali që tkurret dhe jo agregatet.

11. Absorbimi i ujit në sipërfaqe redukton forcat shtypëse dhe tensionin sipërfaqësor me rezultat mufatjen e pastës së çimentos C-S-H.

Tkurrja zvogëlon rezen e meniskit r me pasojë ndryshimin e presionit të avullit e forcat shtypëse në skelet do të gjenerojnë shtypje në sistem.

Uji i absorbuar redukton tensionin sipërfaqësor, energjinë sipërfaqësore me pasojë që sforcimet kritike mund të shkaktojnë thyerje të frakturave të skeletit e poret do të zvogëlohen

Deformimet totale nga tkurrja mund të llogariten pa marrë në konsideratë, për shkak të vlerave të vogla, tkurrjen plastike dhe tkurrjen nga karbonatizimi me formulën:

$$\epsilon_{cs} = \epsilon_{cd} + \epsilon_{ca} \quad 3.4.1.$$

$\epsilon_{cs} \rightarrow$ janë deformimet totale nga tkurrja.

$\epsilon_{cd} \rightarrow$ janë deformimet nga tkurrja e thatë.

$\epsilon_{ca} \rightarrow$ janë deformimet nga tkurrja autogenoze.

Procesi i tkurrjes skematikisht jepet në Fig.3.4.3.




Fig.3.4.3. Skematikisht procesi i tkurrjes së betonit .

3.5. Llogaritja e tkurrjes sipas EC 2.

Tkurrja si edhe deformkoha janë veti të betonit në terma afatgjatë. Ndikimet e tyre duhet të merren në llogaritje në gjendjen kufitare për të siguruar elementin në rastin kur efektet e rendit të dytë janë përcaktuese në aftësinë mbajtëse të tij ose për verifikimin e gjendjes kufitare të shfytëzimit.

Deformimet totale nga tkurrja përbëhen nga dy komponente, deformimet nga tkurrja e thatë dhe tkurrja autogenoze. Deformimet nga tkurrja e thatë zhvillohen ngadalë sipas një funksioni të migrimit të ujit përmes betonit të ngurtësuar. Deformimet nga tkurrja autogenoze zhvillohen gjatë procesit të ngurtësimit të betonit, ku pjesa kryesore e tyre zhvillohet në ditët e para pas hedhjes së betonit në vepër. Tkurrja autogenoze është një funksion linear i sforcimeve në beton. Vlera e deformimeve prej tkurrjes totale ε_{sc} jepet me formulën:

$$\varepsilon_{sc} = \varepsilon_{cd} + \varepsilon_{ca} \quad 3.5.1.$$

ku:

$\varepsilon_{sc} \rightarrow$ janë deformimet nga tkurrja totale.

$\varepsilon_{cd} \rightarrow$ janë deformimet nga tkurrja e thatë.

$\varepsilon_{ca} \rightarrow$ janë deformimet nga tkurrja autogenoze.

Deformimet përfundimtare nga tkurrja e thatë jepen me shprehjen:

$$\varepsilon_{cd, \infty} = k_h \cdot \varepsilon_{cd,0} \quad 3.5.2$$

Ku:

$$\varepsilon_{cd,0} = 0.85[(220 + 110 \cdot \alpha_{ds1}) \cdot \exp\left(-\alpha_{ds2} \cdot \frac{f_{cm}}{f_{cm0}}\right)] \cdot 10^{-6} \cdot \beta_{RH} \quad 3.5.3$$

$$\beta_{RH} = 1.55 \left[1 - \left(\frac{RH}{RH_0}\right)^3\right] \quad 3.5.4.$$

Ku :

f_{cm} është forca shtypëse në (MPa)

$f_{cm0} = 10$ MPa

α_{ds1} është një koeficient që varet nga tipi i çimentos së përdorur në prodhimin e betonit.

$\alpha_{ds1} = 3$ per çimento të klasës S

$\alpha_{ds1} = 4$ per çimento të klasës N

$\alpha_{ds1} = 6$ per çimento të klasës R

α_{ds2} është një koeficient që varet nga tipi i çimentos .

$\alpha_{ds2}=0.13$ per çimento të klasës S

$\alpha_{ds2}=0.12$ per çimento të klasës N

$\alpha_{ds2}=0.11$ per çimento të klasës R

RH është lagështia relative ambjentale në % dhe $RH_0 = 100\%$

Zhvillimi i tkurrjes së thatë në momentin e kohës t jepet me formulën:

$$\varepsilon_{cd}(t)=\beta_{dc}(t,t_s)\cdot k_h\cdot \varepsilon_{cd,0} \quad 3.5.5.$$

Ku k_h përcaktohet nga raporti $h_0=2A_c/u$ në tabelën e mëposhtme, ku A_c është sipërfaqja e prerjes tërthore dhe u është perimetri i elementit të ekspozuar në atmosferë.

h_0	k_h
100	1
200	0.85
300	0.75
>500	0.7

$$\beta_{ds}(t, t_s) = \frac{(t - t_s)}{(t - t_s) + 0.04\sqrt{h_0^3}} \quad 3.5.6.$$

$t \rightarrow$ është mosha e betonit në momentin e konsideruar në llogaritje në ditë

$t_s \rightarrow$ është mosha e betonit në fillimin e konsideruar në llogaritje të tkurrjes së thatë. Ky moment është fundi i ngurtësimit.

Tkurrja autogenoze përcaktohet nëpërmjet deformimeve të dhëna nga formula e mëposhtme:

$$\varepsilon_{ca}(t) = \beta_{as}(t) \cdot \varepsilon_{ca}(\infty) \quad 3.5.7.$$

Ku:

$$\varepsilon_{ca}(\infty)=2.5(f_{ck}-10)10^{-6} \text{ dhe } \beta_{as}(t)=1-\exp(-0.2t^{0.5}) \quad 3.5.8.$$

Ku t jepet në ditë.

3.6. Agresiviteti ambjental në beton.

Klasifikimi ambjental për strukturat prej betoni të armuar sipas EN206-1 përcakton klasat e rrezikshmërisë sipas renditjes së mëposhtme:

XO → nuk ka risk korrodimi

XC → vlerësohet risku i karbonatizimit përfshirë korrodimin

XD → vlerësohet risku i veprimit të klorideve përfshirë korrodimin për strukturat që nuk janë nën ndikimin direkt të ujit të detit.

XF → vlerësohet risku i veprimit të klorideve përfshirë korrodimin për strukturat që janë nën ndikimin direkt të ujit të detit.

XA → vlerësohet shkatërrimi kimik

Në varësi të klasifikimit ambjental bëhet përzgjedhja e klasës minimale të betonit dhe shtresës mbrojtëse minimale për strukturat prej betoni të armuar. Kolonat duke qenë elementë mjaft të ekspozuar në ambjentin e jashtëm dhe përbëjnë elementët kryesorë vertikalë mbajtës duhet të vlerësohen në aspektin e klasifikimit ambjental për llogaritje në durabilitet të strukturës.

4. Ndikimi i tkurrjes dhe deformkohës në analizën e rendit të dytë të elementëve prej betoni të armuar.

4.1. Analiza e rendit të dytë.

Diskutimi në këtë kapitull do të përqëndrohet në elementët konstruktivë dhe strukturat në të cilat sjellja e tyre influencohet nga efektet e rendit të dytë të elementëve të tillë si kolona, mure, pilota etj. Në këto raste llogaritja në aftësi mbajtëse do të realizohet duke marrë në konsideratë gjendjen e deformuar pas ngarkimit. Deformacionet do të përcaktohen duke llogaritur madhësinë dhe ndikimin e plasaritjeve, vetitë jo-lineare të materialeve dhe deformkohën. Efektet e rendit të dytë mund të neglizhohen nëse janë më pak se 10% se efektet korresponduese të rendit të parë. Kolonat e holla janë një nga elementët konstruktivë ku në llogaritjen e tyre duhet të konsiderohet efekti i deformkohës dhe tkurrjes së betonit.




Fig. 4.1.1. Ndikimi i efektit të rendit të dytë në skemën e deformuar të elementit konstruktiv tip kolonë e hollë.

Skema (a) tregon gjendjen e padeformuar të kolonës, ku e_e është jashtëqendërsia e rendit të parë, në skemën (b) e_1 është jashtëqendërsia aksidentale dhe në skemën (c) e_2 është jashtëqendërsia e rendit të dytë.

4.2. Kriteret e perkulshmërie për elementët e vecuar.

Sipas EC2 efekti i rendit të dytë mund të neglizhohet në elementët kolonë betonarme nëse perkulshmëria:

$$\lambda = l_0 / i < \lambda_{\text{lim}} \quad 4.2.1.$$

Ku:

$l_0 \rightarrow$ është gjatësia efektive e elementit.

$i \rightarrow$ rrezja e inercisë së seksionit të pa plasaritur të betonit. $i = \sqrt{\frac{I_c}{A_c}}$

Sipas EC2 [2004] gjatësia efektive për elementët e veçuar mund të përcaktohet sipas skemave në Fig.4.2.1. për elementët me seksion konstant përgjatë gjithë gjatësisë.




Fig. 4.2.1. Gjatësia efektive për elementët e veçuar.

Për elementët tip kolonë pjesë e ramave gjatësia efektive l_0 përcaktohet nëpërmjet shprehjeve :

a) Për elementët tipi (f) sipas Fig.4.2.1.

$$l_0 = 0.5l \sqrt{\left(1 + \frac{k_1}{0.45 + k_1}\right) \cdot \left(1 + \frac{k_2}{0.45 + k_2}\right)} \quad 4.2.2$$

a) Për elementët tipi (g) sipas Fig.4.2.1.

$$l_0 = l \cdot \max \left\{ \sqrt{\left(1 + 10 \frac{k_1 \cdot k_2}{k_1 + k_2}\right)} ; \left(1 + \frac{k_1}{1 + k_1}\right) \cdot \left(1 + \frac{k_2}{1 + k_2}\right) \right\} \quad 4.2.3.$$

Ku k_1 dhe k_2 përkatësisht janë fleksibilitetet relative të mberthimit në nyjet 1 dhe 2 përkatësisht ku: $k = (\theta/M) \cdot (EI/l)$

$\theta \rightarrow$ është këndi i rotullimit të nyjeve shkaktuar nga momenti përkulës M.

$EI \rightarrow$ është shtangësia e kolonës dhe l është lartësia ose distanca midis dy skajeve ose nyjeve të kolonës.

Për rastet e tjera kur forca normale ndryshon dhe /ose seksioni tërthor nuk është konstant gjatë gjithë lartësisë së elementit $l_0 = \pi \sqrt{EI/NB}$ është lartësia

efektive, NB është forca normale kritike ku elementi humbet qendrueshmërinë dhe i është rrezja e inercise e një seksioni pa plasje, rreth aksit për të cilin do të llogarisim.

Për llogaritjen e λ_{lim} vlerat e rekomanduara janë:

$$\lambda_{lim} = \frac{20 A B C}{\sqrt{n}} \quad 4.2.4.$$

ku: $A = 1/(1 + 0.2 \varphi_{ef})$; $B = \sqrt{1 + 2\omega}$; $C = 1.7 - r_m$; $n = N_{Ed}/(A_c \cdot f_{cd})$; dhe

$$\omega = A_s \cdot f_{yd} / (A_c \cdot f_{cd})$$

$A_s \rightarrow$ është sipërfaqja totale e armimit

$n \rightarrow$ është forca normale relative ku $n = N_{Ed}/(A_c \cdot f_{cd})$

$r_m = M_{01}/M_{02}$ është raporti i momenteve ku M_{01} , M_{02} janë momentet e rendit të parë në skajet e elementit dhe $|M_{02}| > |M_{01}|$. Nëse momentet në skajet janë në të njëjtën anë r_m merret në llogaritje pozitive nëse momentet në kolonë janë në anë të ndryshme atëherë r_m do të merret negative dhe nëse një nga momentet në skajet e kolonës është 0 atëherë $r_m = 0$.

Në rastet e përkuljes dyaksiale kriteret e përkulshmerisë duhet të kontrollohen në mënyrë të pavarur për secilin drejtim. Në varesi të situatës aktuale të punës së kolonës efektet e rendit të dytë mund të mos merren në llogaritje në të dy drejtimet por mund të merren në llogaritje në një drejtim ose mund të merren në llogaritje në të dy drejtimet.

Ndikimi i deformkohës do të merret në llogaritjen e analizës së rendit të dytë duke pranuar vlerësimin e deformkohës referuar ndikimit të ngarkesave sipas një kombinimi të caktuar kur ngarkesat veprojnë në një interval të përcaktuar kohor afatgjatë.

Raporti efektiv i deformkohës ose koeficienti i reduktuar i deformkohës është:

$$\varphi_{ef} = \varphi(\infty, t_0) \cdot M_{0Eqp}/M_{0Ed} \quad 4.2.5.$$

Ku: $\varphi(\infty, t_0) \rightarrow$ është koeficienti final i deformkohës.

$M_{0Eqp} \rightarrow$ është momenti përkulës i rendit të parë në kombinimin e ngarkesave (SLS): $[G_{k,j} + \Sigma \psi_{2,i} Q_{k,i}]$

$M_{0Ed} \rightarrow$ është momenti përkulës i rendit të parë sipas kombinimit të ngarkesave të projektimit (ULS): $[\Sigma \gamma_{G,j} G_{k,j} + \gamma_{Q,1} Q_{k,1} + \Sigma \gamma_{Q,i} \psi_{0,i} Q_{k,i}]$

Koeficienti efektiv i deformkohës mund të mos merret parasysh në llogaritje

$\varphi_{ef} = 0$ nëse plotësohen tre kushte:

$$\varphi(\infty, t_0) \leq 2$$

$$\lambda \leq 75;$$

$$M_{0Ed}/N_{Ed} \geq h$$

$M_{0Ed} \rightarrow$ është momenti përkulës i rendit të parë në drejtimin korrespondues.

$N_{Ed} \rightarrow$ është vlera e projektimit e forcës aksiale të aplikuar.

$h \rightarrow$ është lartësia e prerjes tërthore të seksionit.

4.3. Metodatat e thjeshtuara analitike për llogaritjen e kolonave të holla.

Tre janë metodat kryesore për llogaritjen e kolonave të holla referuar përkuljes një aksiale ku faktorët deformkohë e tkurrje japin ndikimin e tyre në përcaktimin e momenteve shtesë të rendit të dytë sipas EC2 për përkuljen një aksiale.

a) Metoda e përgjithshme.

b) Metoda e shtangësisë nominale (N.S.).

c) Metoda e kurbaturës nominale (N.C.).

Metoda (b) mund të perdoret për llogaritjen e elementëve të vecuar por edhe për llogaritjen e gjithë strukturës.

Metoda (c) është më e përshtatshme për llogaritjen e elementëve të vecuar.

a) Metoda e përgjithshme.

Metoda e përgjithshme për llogaritjen e kolonave të holla bazohet në marrëdhënien sforcim-deformim të betonit sipas grafikut të mëposhtëm në Fig.4.3.1.

Funksioni $\sigma_c - \epsilon_c$ jepet me shprehjen:

$$\frac{\sigma_c}{f_{cm}} = \frac{k\eta - \eta^2}{1 + (k - 2)\eta} \quad 4.3.1$$

Ku: $\eta = \epsilon_c / \epsilon_{c1}$ dhe $\epsilon_{c1} = 0.7 \cdot f_{cm}^{0.31} < 2.8$

$k = 1.05 E_{cm} \cdot |\epsilon_{c1}| / f_{cm}$ dhe $0 < |\epsilon_c| < |\epsilon_{cu1}|$ ku ϵ_{cu1} janë deformimet nominale kufitare.

Moduli i elasticitetit të betonit varet nga përbërja e agregateve mbushëse dhe për seksionin pa të plasura, varësia lineare sforcim- deformim merret me vlerë të mesatarizuar të modulit të elasticitetit midis $\sigma_c=0$ dhe $\sigma_c=0.4 \cdot f_{cm}$, ku f_{cm} është rezistenca në shtypje e mostrave cilindrike. Koeficienti i Puasonit është 0.2 për betonin e pa plasaritur dhe 0 për betonin e plasaritur.




Fig.4.3.1. Varësia sforcim- deformim e sjelljes së betonit.

Moduli i elasticitetit E_{cd} është:

$$E_{cd}/\gamma_{cE} \quad \text{ku } \gamma_{cE}=1.2$$

Në këtë metodë deformkoha merret në konsideratë vetëm me shumëzimin e vlerave të deformimeve relative me koeficientin $(1+ \varphi_{ef})$




Fig. 4.3.2. Diagrama sforcim deformim e sjelljes së betonit dhe ndikimi i deformkohës.

Referuar diagramës së Fig. 4.3.2.vërehet se diagrama e sjelljes së betonit σ - ε spostohet djathtas dhe për të njëjtin sforcim deformimet janë më të mëdha në vlerë sa deformimet fillestare të shkaktuara nga gjendja e sforcuar shumëzuar me koeficientin $(1+ \varphi_{ef})$ që është numur më i madh se 1.

Në fazën elastike të punës së betonit ndikimi i deformkohës mund të shprehet grafikisht si në Fig. 4.3.3.




Fig.4.3.3. Diagrama sforcim-deformime relative të betonit. Efekti i deformkohës, ndryshimi i modulit të elasticitetit në kondita lineare. Westernberg 2008.

Duke konsideruar se ekziston një kurbë e sjelljes së betonit të korigjuar me koefiçientin e deformkohës për kondita jo-lineare referuar momentit t_0 të aplikimit të ngarkesës diagrama σ - ε ndryshon si në Fig. 4.3.4.




Fig.4.3.4. Diagrama e sforcim-deformime relative të betonit. Efekti i deformkohës, ndryshimi i modulit të elasticitetit në kondita jolineare. Westernberg 2008.

$$\Delta\varepsilon = \Delta\varepsilon_\sigma + \Delta\varepsilon_\varphi \quad 4.3.2.$$

Ku: $\Delta\varepsilon_\sigma = (1+\varphi_i) \cdot \Delta\varepsilon_0$

$$\Delta\varepsilon_\varphi = \Delta\varphi \cdot \varepsilon_{0,i-1}$$

$\Delta\varepsilon_\sigma \rightarrow$ është ndryshimi i deformimeve për ndryshim $\Delta\sigma$ paraqitur në diagramën σ - ε .

$\Delta\varepsilon_\varphi \rightarrow$ është rritja e deformimeve relative për shkak të deformkohës.

Llogaritja bëhet vetëm për seksionet kritike.

b) Metoda e shtangësisë nominale (N.S.)

Referuar kësaj metode analiza e rendit të dytë bazohet në shtangësinë e elementit duke marrë në llogaritje efektet e plasaritjeve, jo-linearitetin e sjelljes së materialit të betonit dhe deformkohën.

Kjo metodë bazohet në llogaritjen e shtangësisë nominale (NS) të elementëve që punojnë në shtypje me seksion të cfarëdoshëm të prerjes tërthore:

$$EI = K_c \cdot E_{cd} \cdot I_c + K_s \cdot E_s \cdot I_s \quad 4.3.3.$$

$$E_{cd} = E_{cm} / \gamma_{ce} \quad 4.3.4.$$

$E_{cd} \rightarrow$ vlera e projektuar e modulit të elasticitetit të betonit dhe $\gamma_{ce} = 1.2$

$I_c \rightarrow$ momenti i inercise së prerjes tërthore të seksionit të betonit.

$E_s \rightarrow$ vlera e modulit të elasticitetit të armaturës.

$I_s \rightarrow$ momenti i rezistencës së sipërfaqes së armaturës rreth qendrës së gravitetit të sipërfaqes së betonit.

$K_c \rightarrow$ koeficienti i ndikimit të deformkohës.

$K_s \rightarrow$ koeficienti i kontributit të armaturës.

Kur $\rho \geq 0.002$, ku $\rho = A_s / A_c$.

$$K_s = 1, \quad K_c = k_1 \cdot k_2 / (1 + \varphi_{ef}) \quad 4.3.5.$$

$\varphi_{ef} \rightarrow$ raporti i deformkohës efektive.

$A_s \rightarrow$ sipërfaqja totale e armimit

$A_c \rightarrow$ sipërfaqja e prerjes tërthore të elementit.

$$k_1 = \sqrt{\frac{f_{ck}}{20}}; \quad k_2 = n \frac{\lambda}{170} < 0.20 \quad 4.3.6.$$

$n = N_{Ed} / (A_c \cdot f_{cd})$ dhe λ është raporti i përkulshmërisë.

Kur $\rho \geq 0.01$, ku $\rho = A_s / A_c$.

Si një vlerë alternative mund të merret $K_s = 0$, $K_c = 0.3 / (1 + 0.5\varphi_{ef})$

$\varphi_{ef} \rightarrow$ është raporti i deformkohës efektive.

Shtangësia bazohet në modulën efektiv të betonit $E_{cd, eff} = E_{cd} / (1 + \varphi_{ef})$

Momenti përfundimtar llogaritet duke përfshirë dhe momentet e rendit të dytë është:

$$M_{Ed} = M_{0Ed} \left[1 + \frac{\beta}{\left(\frac{N_B}{N_{Ed}} - 1 \right)} \right] \quad 4.3.7.$$

$M_{0Ed} \rightarrow$ është momenti i rendit të parë.

$\beta \rightarrow$ është një koeficient që varet nga mënyra e shpërndarjes së momenteve të rendit të parë dhe të dytë.

$N_{Ed} \rightarrow$ është forca aksiale e projektimit.

$N_B \rightarrow$ është vlera e forcës aksiale kufitare kritike e qendrueshmërisë llogaritur me metodën e shtangësisë nominale (NS).

b.1) Për elementët e vecuar me seksion dhe forcë aksiale konstante për gjatë gjithë gjatësisë ku momenti i rendit të dytë ka formë sinusoidale koeficienti β është llogaritur $\beta = \pi^2 / c_0$.

$c_0 \rightarrow$ është një koeficient që varet nga mënyra e shpërndarjes së momenteve të rendit të parë.

$c=8$ për shpërndarje konstante të momentit gjatë gjithë gjatësisë.

$c=9.6$ për shpërndarje parabolike të momentit.

$c=12$ për shpërndarje trekëndore simetrike të momentit.

b.2) Nëse shpërndarja e momenteve të rendit të parë e të dytë nuk korrespondon me pikën (b.1) atëhere koeficienti $\beta=1$ në llogaritje. Në këtë rast momenti përkulës llogaritet me formulën:

$$M_{Ed} = \frac{M_{0Ed}}{1 - \frac{N_{Ed}}{N_B}} \quad 4.3.8.$$

Momenti përfundimtar llogaritet përcaktohet referuar koeficientit të zmadhimit të momentit në llogaritjen e kolonave të holla me metodën e shtangësisë nominale N.S. Paraqitja e mënyrës së llogaritjes jepet me një bllok skemë në Fig.4.3.5. ku vihet re ndikimi i parametrave të deformkohës nëpërmjet koeficientit të defomkohës dhe koeficientit efektiv ose te reduktuar të defomkohës.




Fig.4.3.5. Bllok skema për llogaritjen e momentit përkulës në kolonat e holla. Ndikimi i koeficientit të deformkohës.

- (1) Llogaritet paraprakisht koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$.
- (2) Hapi i dytë përcakton kushtet për llogaritjen e koeficientit efektiv ose të reduktuar të deformkohës.
- (3) Llogaritja e koeficientit efektiv ose të reduktuar të deformkohës referuar kombinimit të ngarkesave ULS ose SLS pothuaj shërben për llogaritjen e strukturave në terma afatgjatë:
- (4) Për armim të kolonës me përqindje më të madhe se 1% përcakton kushtet për thjeshtimin e llogaritjes së koeficientëve k_c dhe k_s .
- (5) k_1 dhe k_2 koeficientë që kontribuojnë indirekt në llogaritjen e madhësisë së hapjes të të plasurave.
- (6) Llogaritet shtangësia EI efektive e kolones për shkak të reduktimit të sipërfaqes së betonit nga plasaritjet.
- (7) Vlerësohet momenti përkulës shtesë afërsisht në mes të kolonës ku sipas skemës së deformuar të kolonës momentet përkulëse shtesë kanë arrijnë vlerat maksimale të tyre.
- (8) Përcaktohet momenti llogaritës për kolonat të holla referuar skemës së deformuar me kurbaturë dyfishe sipas Fig.4.3.7. Rasti I.

c) Metoda e kurbaturës nominale (N.C.)

Kjo metodë është e përshtatshme për llogaritjen e elementëve të vecuar. Duke analizuar elementët tip kolonë pjesë e strukturave në llogaritje të konsideruar si elementë të vecuar përdorimi i metodës NC jep rezultate të sakta në rastet e llogaritjes së elementëve me ngarkesa konstante aksiale. Kjo metodë llogarit momentet e rendit të dytë bazuar në skemën e deformuar duke përcaktuar kurbaturën maksimale të aksit të deformuar të elementit.

Nëpërmjet kësaj metode llogariten momentet e rendit të dytë bazuar në deformimin e aksit të kurbëzuar të elementit. Momenti jepet me shprehjen:

$$M_{Ed} = M_{0Ed} + M_2 \quad 4.3.9.$$

$M_{0Ed} \rightarrow$ momenti i rendit të parë. Mund të gjendet në simbolikë edhe si M_{0e} .

$M_2 \rightarrow$ momenti shtesë i rendit të dytë.

Për vlera të ndryshme të momentit përkulës në skajet e elementit M_{01} dhe M_{02} momenti ekuivalent i rendit të parë llogaritet :

$$M_{0e} = 0.6 \cdot M_{02} + 0.4 \cdot M_{01} \geq 0.4 \cdot M_{02} \quad 4.3.10.$$

M_{01} dhe M_{02} kanë të njëjtën shenjë nëse janë nga e njëjta anë e elementit ose vendosen me shenja të kundërta kur janë në anë të ndryshme, por

$$|M_{02}| \geq |M_{01}|$$

Momenti i rendit të dytë:

$$M_2 = N_{Ed} \cdot e_2 \quad 4.3.11.$$

$N_{Ed} \rightarrow$ është forca aksiale e projëktimit.

$e_2 \rightarrow$ është jashtëqendërsia për shkak të skemës së deformuar

$$e_2 = (1/r) l_0^2 / c \quad 4.3.12.$$

$1/r$ është kurbatura, l_0 është gjatësia efektive dhe c është një koeficient që jep ndikimin e formës së kurbaturës e për elementin me prerje tërthore konstante merr vlerën $c = 10 \approx \pi^2$

Kurbatura jepet me formulën:

$$1/r = K_r \cdot K_\phi \cdot 1/r_0 \quad 4.3.13.$$

$K_r = (n_u - n) / (n_u - n_{bal})$ është koeficient korrigjimi dhe varet nga ngarkesa aksiale.

$n = N_{Ed} / (A_c f_{cd}) \rightarrow$ është forca relative aksiale

$N_{Ed} \rightarrow$ është forca aksiale e projektimit.

$$n_u = 1 + \omega$$

$n_{bal} = 0.4$ paraqit vlerën maksimale të n .

$A_s \rightarrow$ është sipërfaqja totale e armimit.

$A_c \rightarrow$ është sipërfaqja e seksionit tërthor të betonit.

$K_\phi = 1 + \beta \cdot \phi_{ef} \geq 1$ është koeficient korrigjimi që merr në llogaritje efektin e deformkohës nëpërmjet koeficientit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} dhe $\beta = 0.35 + f_{ck} / 200 - \lambda / 150$ ku jepet ndikimi i klasës së betonit dhe përkulshmërisë λ .

Përkulja dy-aksiale.

Metoda e përgjithësuar përdoret për llogaritjen e elementëve në përkulje dy-aksiale. Paraprakisht përcaktohen përkulshmëritë e elementit λ_y dhe λ_z .




Fig.4.3.6. Përcaktimi i jashtëqendërsive e_y , e_z .

Si hap i parë i llogaritjes bëhet llogaritja e përkulshmërisë kufitare eferuar secilit drejtim në mënyrë të pavarur nga drejtimi tjetër përkatësisht sipas y dhe z pa marrë në konsideratë ndikimin e tyre reciprok.

Nëse plotësohen konditat e mëposhtme nuk është e nevojshme të bëhen kontrole të tjera.

$$\lambda_y / \lambda_z \leq 2; \quad \lambda_z / \lambda_y \leq 2; \quad \frac{e_y / h_{eq}}{e_z / b_{eq}} \leq 0.2; \quad \frac{e_z / b_{eq}}{e_y / h_{eq}} \leq 0.2 \quad 4.3.14.$$

Parametrat janë si në Fig.4.3.6. dhe $b_{eq} = i_y \cdot (12)^{0.5}$; $h_{eq} = i_z \cdot (12)^{0.5}$

$e_z = M_{Edy} / N_{Ed}$ dhe përfaqëson jashtëqendërsinë sipas aksit z.

$e_y = M_{Edz} / N_{Ed}$ dhe përfaqëson jashtëqendërsinë sipas aksit y.

M_{Edy} është përkulës rreth aksit y duke përfshirë dhe momentin e rendit të dytë.

M_{Edz} është përkulës rreth aksit z duke përfshirë dhe momentin e rendit të dytë.

N_{Ed} është forca aksiale respektive në kombinimin e zgjedhur të ngarkesave.

Nëse konditat e mësipërme nuk plotësohen përkulja dy-aksiale duhet të merret në llogaritje përfshirë efektet e rendit të dytë në cdo drejtim.

Diagramat e momenteve për llogaritjen e kolonave duke marrë në konsideratë efektet e rendit të dytë jepen në Fig.4.3.7.




Fig.4.3.7. Diagramat e momenteve përkulëse për kolonat e holla me nyje të paspostueshme dhe me nyje të spostueshme.

Për llogaritjen e kolonave të holla në shtypje jashtëqendrore dy aksiale përcaktohet jashtëqendërsia ekuivalente për secilin drejtim të punës së elementit duke konsideruar skemën e deformuar të kolonës në drejtimin tjetër dhe eksentricitetin aksidental.

Jashtëqendërsia totale e llogaritjes për secilin drejtim jepet me formulën:

$$e_{\text{tot}} = e_0 + e_a + e_2$$

e_0 është jashtëqendërsia e rendit të parë

e_a është jashtëqendërsia aksidentale

e_2 është jashtëqendërsia e shkaktuar nga efektet e rendit të dytë.

Jashtëqendërsia aksidentale përcaktohet nga kushtet:

$$e_a = 0.5 \cdot v \cdot l_0 \quad 4.3.15.$$

$$v = \frac{1}{100\sqrt{l}} \geq \frac{1}{200} \quad 4.3.16.$$

Për të përcaktuar kapacitetin mbajtës të kolonave ndërtohen kurbat e interaksionit M, N . Pika 1 në Fig. 4.3.8. paraqet elementin në shtypje të pastër, pika 2 paraqet elementin në tërheqje të pastër, pika 3 jep seksionin e balancuar të elementit.




Fig.4.3.8. Diagramat e interaksionit M-N




Fig.4.3.9. Diagramat e interaksionit M-N për kolonat. Ndryshimi i kurbaturës për nivele të ndryshme të aplikimit të forcës aksiale.

Disa nga kurbat e interaksionit jepen në Fig.4.3.10., Fig.4.3.11.




Fig.4.3.10. Grafikët për llogaritjen e kolonave për betonin me rezistencë $f_{ck} \leq 50$ Mpa




Fig.4.3.11. Grafikët për llogaritjen e kolonave për betonin me rezistencë $f_{ck}=70$ MPa

5. Studimi i faktorëve që ndikojnë në deformkohën dhe tkurrjen e betonit. Raste studimi.

5.1. Ndikimi i kushteve ambjentale dhe klasës së çimentos në përbërje të betonit në deformkohën e tkurrjen e betonit.

Një nga faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e parametrave të deformkohës dhe tkurrjes së betonit është lagështia relative ambjentale përreth elementit konstruktiv. Studimi do të përqëndrohet në ndikimin e RH% në rastet e llogaritjes së elementëve tip kolonë e hollë. Elementët llogariten sipas EC 2 me të dy metodat N.S, dhe N.C. duke rruajtur të njëjtën klasë betoni e shqyrtohen rastet kur betoni ka në përmbajtje çimento së tipit R, N, S përkatësisht.

Në llogaritje merret kolona e hollë nga veprimi i forcës normale N e paraqitur skematikisht në Fig.5.1.1.

Kolona është me seksion tërthor katërkëndësh këndrejtë me përmasa 400x400mm me armaturë të shpërndarë uniformisht. Analiza bazohet për klasë ambjentale XC3 me lagështi relative mesatare klasifikuar sipas Table 4.1 EN 1992-1-1:2004. Klasa e betonit është C30/37 dhe shtresa mbrojtëse është 40mm. Ngarkesa e pare e aplikuar brenda periudhës kohore $t_0=90$ ditë. Forca aksiale është $N_{Ed}=2025(kN)$, lartësia e kolonës është 4.5m dhe gjatësia efektive është $l_0=2\cdot4.5=9m$.

Për çdo llogaritje do të ndryshohen një ose disa parametra për të studjuar influencën e tyre në raportin e deformkohës efektive, koeficientin e deformkohës dhe efektet e rendit të dytë.

Këto parametra janë lagështia relative ambjentale RH% dhe klasa e çimentos. RH% do të ndryshohet nga 45% -80% dhe klasa e çimentos është R, N, S për cdo llogaritje. Parametrat e tjerë si forca e aplikuar ($N_{Ed}=2025kN$), klasa e betonit C30/37 dhe armatura $A_s=2512mm^2$ me shpërndarje uniforme përgjatë perimetrit janë mbajtur konstante. Fig. 5.1.1. jep skemen e kolonës në shtypje, dimensionimin e prerjes tërthore, gjatësinë e kolonës, gjatësinë efektive dhe shtresën mbrojtëse.

Llogaritjet janë bërë me metodat NS dhe NC dhe raporti i deformkohës efektive, koeficienti i deformkohës dhe efektet e rendit të dytë janë llogaritur për cdo rast. Rezultatet jepen në mënyrë tabelare dhe grafike. Krahassimi i vlerave konkrete bëhet për cdo llogaritje nëpërmjet tabelave përmbledhëse dhe krahasimit grafik.




Fig.5.1.1. Kolonë e hollë me seksion konstant dhe armaturë të shpërndarë uniformisht në perimentër.

Llogaritjet për secilin rast janë dhënë në mënyrë tabelare përkatësisht:

Tab.5.1.1. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 45%

Tab.5.1.2. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 50%

Tab.5.1.3. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 55%

Tab.5.1.4. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 60%

Tab.5.1.5. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 65%

Tab.5.1.6. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 70%

Tab.5.1.7. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 75%

Tab.5.1.8. paraqit llogaritjen e kolonës me metodat N.S. dhe N.C. për RH 80%




Fig. 5.1.2. Pamje e skemës llogaritëse të kolonës sipas dy akseve kryesore y dhe z.




Fig. 5.1.3. Pamje e kolonave të holla. Uzina e Ferrokromit, Elbasan.

Deformkoha dhe tkurrja e betonit

Tab.5.1.1.

Kol 400x400, RH=45%, Betoni C30/37, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	20.91			21027.1		1.79	242.77	40.5		40.5	40.5		2.41
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	22.96		0.11		0.02	1.79	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.41
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	20.77			20945.9		1.83	246.52	40.5		40.5	40.5		2.47
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	22.8		0.11		0.02	1.83	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.47
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	20.61			20853		1.89	250.98	40.5		40.5	40.5		2.55
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	22.62		0.11		0.02	1.89	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.55

Tab.5.1.2.

Kol. 400x400, RH=50%, Betoni C30/37, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	21.15			21168.1		1.71	236.58	40.5		40.5	40.5		2.31
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	23.22		0.11		0.01	1.71	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.31
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	21.01			21085.9		1.75	240.14	40.5		40.5	40.5		2.37
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	23.07		0.11		0.01	1.75	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.37
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	20.85			20991.8		1.81	244.38	40.5		40.5	40.5		2.44
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	22.89		0.11		0.01	1.81	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.44

Deformkoha dhe tkurrja e betonit

Tab.5.1.3.

Kol. 400x400, RH=55%, Betoni C30/37, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	21.4			21317.2		1.63	230.43	40.5		40.5	40.5		2.2
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	23.49		0.11		0.01	1.63	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.2
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	21.26			21234.1		1.67	233.81	40.5		40.5	40.5		2.26
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	23.34		0.11		0.01	1.67	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.26
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	21.1			21138.8		1.72	237.83	40.5		40.5	40.5		2.33
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	23.17		0.11		0.01	1.72	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.33

Tab.5.1.4.

Kol. 400x400, RH=60%, Betoni C30/70, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	21.64			21475.3		1.56	224.33	40.5		40.5	40.5		2.1
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	23.76		0.11		0.01	1.56	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.1
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	21.51			21391.2		1.6	227.52	40.5		40.5	40.5		2.16
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	23.62		0.11		0.01	1.6	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.16
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	21.36			21294.8		1.64	231.33	40.5		40.5	40.5		2.22
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	23.45		0.11		0.01	1.64	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.22

Deformkoha dhe tkurrja e betonit

Tab.5.1.5.

Kol. 400x400, RH=65%, Betoni C30/37, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞, t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	21.9			21643.1		1.48	218.27	40.5		40.5	40.5		2
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	24.04		0.11		0.01	1.48	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	21.77			21558.1		1.52	221.29	40.5		40.5	40.5		2.05
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	23.9		0.11		0.01	1.52	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.05
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	21.62			21460.6		1.56	224.88	40.5		40.5	40.5		2.11
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	23.74		0.11		0.01	1.56	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2.11

Tab.5.1.6.

Kol. 400x400, RH=70%, Betoni C30/37, Klasa ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞, t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	22.16			21821.5		1.4	212.26	40.5		40.5	40.5		1.89
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	24.33		0.11		0.01	1.4	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.89
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	22.04			21735.6		1.44	215.1	40.5		40.5	40.5		1.94
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	24.19		0.11		0.01	1.44	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.94
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	21.89			21637.1		1.48	218.48	40.5		40.5	40.5		2
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	24.03		0.11		0.01	1.48	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	2

Deformkoha dhe tkurrja e betonit

Tab.5.1.7.

Kol. 400x400, RH=75%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	22.43			22011.6		1.33	206.29	40.5		40.5	40.5		1.79
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	24.62		0.11		0.01	1.33	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.79
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	22.31			21925		1.36	208.95	40.5		40.5	40.5		1.84
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	24.49		0.11		0.01	1.36	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.84
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	22.17			21825.6		1.4	212.13	40.5		40.5	40.5		1.89
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	24.33		0.11		0.01	1.4	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.89

Tab.5.1.8.

Kol. 400x400, RH=80%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm												y			z			
Met.	I	I ₀	Kl.	N _{Ed}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	EI	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	M _{ED}	M _{EDmin}	M ₂	φ(∞,t ₀)
	(m)	(m)	cim.	(kN)			(m)	(m)	(kN*m ²)			(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	(kN*m)	
N.S.	4.5	9	R	2025	77.9	22.7			22214.7		1.25	200.36	40.5		40.5	40.5		1.69
N.C.	4.5	9	R	2025	77.9	24.92		0.11		0.01	1.25	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.69
N.S.	4.5	9	N	2025	77.9	22.59			22127.4		1.28	202.86	40.5		40.5	40.5		1.73
N.C.	4.5	9	N	2025	77.9	24.79		0.11		0.01	1.28	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.73
N.S.	4.5	9	S	2025	77.9	22.45			22027		1.32	205.82	40.5		40.5	40.5		1.78
N.C.	4.5	9	S	2025	77.9	24.64		0.11		0.01	1.32	259.13	40.5	216.17	216.17	40.5	216.2	1.78

5.1.a. Ndikimi i klasës së çimentos dhe lagështisë relative në koeficientin e deformkohës të betonit.

Tab.5.1.a. paraqet vlerat e koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ për betonet e klasës C30/37 me përmbajtje tre tipet e klasës së çimentos R, N, S referuar tabelave të llogaritjes 5.1.1-5.1.8. Në grafikun e Fig.5.1.a., aksi vertikal jep vlerat e koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ dhe aksi horizontal paraqit lagështinë relative RH në (%).

Koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$			
RH(%)	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	2.41	2.47	2.55
50	2.31	2.37	2.44
55	2.2	2.26	2.33
60	2.1	2.16	2.22
65	2	2.05	2.11
70	1.89	1.94	2
75	1.79	1.84	1.89
80	1.69	1.73	1.78

Tab.5.1.a. Koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ dhe lagështia relative RH në %.




Fig.5.1a. Koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ në funksion të lagështisë relative RH %.

Konkluzion 5.1.a.

1. Në betonet me përmbajtje çimentoje të klasës S vlera e koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ është më e madhe në vlerë absolute se koeficientët e deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ për betonet me përmbajtje çimento të klasave N and R përkatësisht. Koeficienti i deformkohës reduktohet në betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N dhe R përkatësisht.
2. Kur lagështia relative ambjentale RH rritet koeficienti i deformkohës zvogëlohet për betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N, R përkatësisht.

5.1.b. Ndikimi i klasës së çimentos dhe lagështisë relative në koeficientin efektiv të deformkohës .

Tab.5.1.b. paraqet vlerat e koeficientit efektiv të deformkohës φ_{ef} për betonet e klasës C30/37 me përmbajtje tre tipet e klasës së çimentos R, N, S referuar tabelave të llogaritjes 5.1.1-5.1.8. Në grafikun e Fig.5.1.b., aksi vertikal jep vlerat e koeficientit efektiv të deformkohës φ_{ef} dhe aksi horizontal paraqit lagështinë relative RH në (%) referuar marrëdhënies:

$$\varphi_{ef} = \varphi(\infty, t_0) \cdot M_{0Eqp} / M_{0Ed} \quad 5.1.b.1.$$

Raporti efektiv i deformkohës φ_{ef}			
RH(%)	Klasa e çimentos		
	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	1.79	1.83	1.89
50	1.71	1.75	1.81
55	1.63	1.67	1.72
60	1.56	1.6	1.64
65	1.48	1.52	1.56
70	1.4	1.44	1.48
75	1.33	1.36	1.4
80	1.25	1.28	1.32

Tab.5.1.b. Raporti efektiv i deformkohës φ_{ef} dhe lagështia relative RH%.

Duke analizuar vlerat e tabelës Tab.5.1.b. vërehet se ka zvogëlim të vlerave të koeficientit efektiv të deformkohës brënda të njëjtës klasë të çimentos së përdorur kur lagështia ambjentale rritet.

Refruar të njëjtës vlere të lagështisë ambjentale. Kalimi në klasat e çimentos përkatësisht R, N, S për të njëjtën klasë betoni sjell rritje të koeficientit efektiv të deformkohës.

Në Fig.5.1.b. paraqiten tre grafike përkatësisht për klasat e çimentos R, N, S ku jepet grafikisht ndikimi i lagështisë relative në koeficientin efektiv të deformkohës.




Fig. 5.1.b. Koeficienti efektiv i deformkohës ϕ_{ef} , dhe lagështia relative RH%.

Konkluzion 5.1.b.

1. Betonet me përmbajtje çimentoje të klasës S gjenerojnë vlera më të medha të koeficientit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} në krahasim me koeficientët efektivë të deformkohës ϕ_{ef} për betonet me përmbajtje çimentoje të klasave N dhe S. Koeficienti efektiv i deformkohës reduktohet në betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N dhe R përkatësisht.
2. Rritja e lagështisë relative ambjentale RH sjell zvogëlim të koeficientit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} për betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N, R.

5.1.c. Ndikimi i klasës së çimentos dhe lagështisë relative në koeficientin e përkuishmërisë λ_{lim} nëpërmjet raportit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} .

Përkuishmëria kufitare λ_{lim} është funksion i koeficientit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} sipas kapitullit 4.2. Nderkohë koeficienti efektiv i deformkohës ϕ_{ef} është funksion i gjendjes së sforcuar të elementit që për kolonat e holla llogaritet nëpërmjet metodave të thjeshtuara N.S. dhe N.C. Vetë koeficienti efektiv i deformkohës ϕ_{ef} ndikohet nga lagështia relative RH, klasa e çimentos dhe metoda llogaritëse. Në vijim jepet ndikimi i faktorëve të përmendur duke analizuar secilin prej tyre sipas llogaritjeve të paraqitura në tabelat Tab.5.1.1 deri Tab.5.1.8.

Tab.5.1.c.1. jep vlerat e përkulshmërisë limite λ_{lim} llogaritur në funksion të lagështisë relative RH (%) për klasën e betonit C30/37 në përbërje me çimento të klasave R, N, S llogaritur me metodën e shtangësisë nominale (N.S.) për kolonat e holla. Në grafikun në vijim të Fig.5.1.c.1., aksi vertikal paraqet përkulshmërinë limite dhe aksi horizontal lagështinë relative RH (%) për secilën klasë të çimentos së përdorur në përbërje të betonit C30/37.

Metoda e shtangësisë nominale N.S.			
λ_{lim}			
RH(%)	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	20.91	20.77	20.61
50	21.15	21.01	20.85
55	21.4	21.26	21.1
60	21.64	21.51	21.36
65	21.9	21.77	21.62
70	22.16	22.04	21.89
75	22.43	22.31	22.17
80	22.7	22.59	22.45

Tab.1.c.1. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH%.

λ_{lim} , llogaritja me metoden N.S. për betonin me çimento të klases R,N,S .




Fig. 5.1.c.1. Përkulshmëria limite λ_{lim} llogaritur me metoden N.S. dhe lagështia relative RH(%) .

Tab.5.1.c.2. paraqet vlerat e përkulshmërisë limite λ_{lim} dhe lagështisë relative RH (%) për betonin e klasës C30/37 me përbërje tre klasat e çimentos R, N, S llogaritur me metodën e kurbaturës nominale (N.C.) për kolonat e holla. Në grafikun e Fig.5.1.c.2., aksi vertikal paraqet përkulshmërinë limite dhe aksi horizontal lagështinë relative RH (%) për secilën klasë të çimentos.

Metoda e kurbaturës nominale N.C.			
λ_{lim}			
RH(%)	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	22.96	22.8	22.62
50	23.22	23.07	22.89
55	23.49	23.34	23.17
60	23.76	23.62	23.45
65	24.04	23.9	23.74
70	24.33	24.19	24.03
75	24.62	24.49	24.33
80	24.92	24.79	24.64

Tab.5.1.c.2. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH%.




Fig. 5.1.c.2. Përkulshmëria limite λ_{lim} llogaritur me metodën N.C. dhe lagështia relative RH(%) .

Tab.5.1.c.3. paraqet vlerat e përkulshmërisë limite λ_{lim} dhe lagështisë relative RH në (%) për betonin e klasës C30/37 me përbërje çimento të klasës R llogaritur me metodën N.S. dhe N.C. Në grafikun e Fig.5.1.c.3., aksi vertikal paraqet përkulshmërinë limite λ_{lim} dhe aksi horizontal lagështinë relative RH (%). Vihet re se përkulshmëria limite është më e madhe në vlerë absolute llogaritur me metodën N.C. Ky ndryshim vjen për shkak të ndikimit në llogaritje të koeficientit efektiv të deformkohës.

λ_{lim}		
Klasa R e çimentos		
RH	Metoda N.S.	Metoda N.C.
45	20.91	22.96
50	21.15	23.22
55	21.4	23.49
60	21.64	23.76
65	21.9	24.04
70	22.16	24.33
75	22.43	24.62
80	22.7	24.92

Tab.5.1.c.3. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH%. Klasa R e çimentos.




Fig.5.1.c.3. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH% llogaritur për klasën R të çimentos me metodat N.S. dhe N.C.

Tab.5.1.c.4. paraqet vlerat e përkulshmërisë limite λ_{lim} dhe lagështisë relative RH në (%) për betonin e klasës C30/37 me përbërje çimento të klasës N llogaritur me metodën N.S. dhe N.C. Në grafikun e Fig.5.1.c.4., aksi vertikal paraqet përkulshmërinë limite λ_{lim} dhe aksi horizontal lagështinë relative RH(%). Vihet re se përkulshmëria limite është më e madhe llogaritur me metodën N.C.

λ_{lim}		
Klasa N e çimentos		
RH	Metoda N.S.	Metoda N.C.
45	20.77	22.8
50	21.01	23.07
55	21.26	23.34
60	21.51	23.62
65	21.77	23.9
70	22.04	24.19
75	22.31	24.49
80	22.59	24.79

Tab.5.1.c.4. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH%. Klasa N e çimentos.




Fig.5.1.c.4. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH% llogaritur për klasën N të çimentos me metodat N.S. dhe N.C.

Tab.5.1.c.5. paraqet vlerat e përkulshmërisë limite λ_{lim} dhe lagështisë relative RH në (%) për betonin e klasës C30/37 me përbërje çimento të klasës S llogaritur me metodën N.S. dhe N.C. Në grafikun e Fig.5.1.c.4., aksi vertikal paraqet përkulshmërinë limite λ_{lim} dhe aksi horizontal lagështinë relative RH (%).

λ_{lim}		
Klasa S e çimentos		
RH	Metoda N.S.	Metoda. N.C.
45	20.61	22.62
50	20.85	22.89
55	21.1	23.17
60	21.36	23.45
65	21.62	23.74
70	21.89	24.03
75	22.17	24.33
80	22.45	24.64

Tab.5.1.c.5. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH%. Klasa S e çimentos.




Fig.5.1.c.5. Përkulshmëria limite λ_{lim} dhe lagështia relative RH% llogaritur për klasën S të çimentos me metodat N.S. dhe N.C.

Konkluzion 5.1.c.

1. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} është më e madhe në rastin e betonit me përmbajtje çimenton e klasës R më pas me përmbajtje të klasës N dhe vlerat më të vogla të përkulshmërisë limite janë për betonet me përmbajtje çimento të klasës S llogaritur me të dy metodat N.S. dhe N.C.
2. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} rritet me rritjen e lagështisë relative RH për të gjitha klasat e çimentos.
3. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} llogaritur me metodën N.S. është më e vogël se ajo e llogaritur me metodën N.C. Sipas rekomandimeve të EC2 metoda N.C. është më e përshtatshme për llogaritjen e elementëve të vecuar në krahasim me metodën N.S. e cila mund të përdoret për të gjithë strukturën por edhe për llogaritjen e elementëve të vecuar tip kolonë e hollë duke vlerësuar secilin element në mënyrë të vecantë.
4. Këto konkluzione në vlerësimin e përkulshmërisë limite λ_{lim} shprehin ndikimin e raportit efektiv të deformkohës.

5.1.d. Ndikimi i klasës së çimentos dhe lagështisë relative në shtangësinë EI të elementëve në shtypje prej betoni të armuar llogaritur me metodën N.S. nëpërmjet raportit efektiv të deformkohës ϕ_{ef} .

Shtangësia e elementëve nën veprimin e forcës normale shtypëse nëpërmjet metodës N.S. përcaktohet me formulën:

$$EI = K_c \cdot E_{cd} \cdot I_c + K_s \cdot E_s \cdot I_s \quad 5.1.d.1.$$

Ku K_c është koeficienti i ndikimit të deformkohës të betonit dhe përcaktohet në kapitullin 4.3.

Kur $\rho \geq 0.01$, ku $\rho = A_s/A_c$:

$$K_c = 0.3 / (1 + 0.5\phi_{ef}) \quad 5.1.d.2.$$

Sipas formulae K_c ndikohet nga vlera efektive e deformkohës që përcaktohet me formulën 5.1.d.2.

Në vijim jepet ndikimi i lagështisë relative dhe klasës së çimentos në shtangësinë e elementëve në shtypje prej betoni të armuar llogaritur me metodën N.S. sipas llogaritjeve të paraqitura në tabelat Tab.5.1.1 deri në Tab.5.1.8.

Tab.5.1.d.1. paraqet vlerat e shtangësisë së elementit EI llogaritur për lagështi relative ambjentale RH nga 45-80% për klasën e betonit C30/37 referuar klasifikimit ambjental XC3 për tre tipet e çimentos në përbërje të betonit R, N, S llogaritur me metodën e shtangësisë nominale N.S.

Grafiku në Fig.5.1.d. paraqit në aksin vertikal shtangësinë EI dhe në aksin horizontal lagështinë relative RH(%) për të gjitha klasat e çimentos.

$$\varphi_{ef} = \varphi(\infty, t_0) \cdot M_{0Eqp} / M_{0Ed} \quad 5.1.d.3.$$

EI(kN*m²) llogaritur me Metodën N.S.			
RH(%)	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	21027.1	20945.9	20853
50	21168.1	21085.9	20991.8
55	21317.2	21234.1	21138.8
60	21475.3	21391.2	21294.8
65	21643.1	21558.1	21460.6
70	21821.5	21735.6	21637.1
75	22011.6	21925	21825.6
80	22214.7	22127.4	22027

Tab.5.1.d. Shtangësia EI sipas metodës N.S.dhe lagështia relative RH(%).




Fig.5.1.d. Shtangësia EI sipas metodës N.S.dhe lagështia relative RH(%).

Konkluzion 5.1.d.

Referuar grafikut të Fig.5.1.d dhe Tab. 5.1.d. shtangësia EI llogaritur me metodën N.S. për elementin në shtypje zvogelohet sipas rendit R, N, S të klasës së çimentos në përbërje të betonit.

5.1.e. Ndikimi i klasës së çimentos dhe lagështisë relative në vlerat e momenteve të rendit të dytë në elementët në shtypje prej betoni të armuar llogaritur me metodën e shtangësisë nominale N.S.

Referuar llogaritjes sipas metodës N.S. sipas EC2 momenti perfundimtar llogaritet në kolonat e holla përcaktohet me formulën:

$$M_{Ed} = M_{0Ed} \left[1 + \frac{\beta}{\left(\frac{N_B}{N_{Ed}} - 1 \right)} \right] \quad 5.1.e.1.$$

Shtangësia Ei sipas 5.1.d. jepet me formulën:

$$EI = K_c \cdot E_{cd} \cdot I_c + K_s \cdot E_s \cdot I_s \quad 5.1.e.2.$$

$$K_c = 0.3 / (1 + 0.5 \varphi_{ef}) \quad 5.1.e.3.$$

Momenti perfundimtar llogaritet referuar efekteve të rendit të dytë ose skemës së deformuar të punës së kolonave të holla është funksion edhe i raportit efektiv të deformkohës φ_{ef} . Sipas 5.1.b. konkluzione 2 rritja e lagështisë relative ambientale RH% sjell zvogëlim të koeficientit efektiv të deformkohës φ_{ef} për betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N, R dhe koeficienti efektiv i deformkohës reduktohet në betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N dhe R përkatësisht.

Tab.5.1.e.1. jep vlerat e momentit përkulës final në llogaritje M_{Ed} në kolonat e holla dhe lagështinë relative RH(%) për betonet e klasës C30/37 në përmbajtje me të tre tippet e çimentos R, N, S përkatësisht.

Grafiku i Fig. 5.1.e. paraqet në aksin vertikal momentet përkulëse të rendit të dytë M_{Ed} (kN*m) dhe në aksin horizontal lagështinë relative RH (%) nga 40%-80% duke konsideruar të gjitha llogaritjet e paraqitura në mënyrë tabelare në Tab.5.1. deri Tab.5.8. për cdo element.

Metoda e shtangesise nominale N.S.			
M_{Ed} (kN*m)			
RH(%)	Çimento e klasës R	Çimento e klasës N	Çimento e klasës S
45	242.77	246.52	250.98
50	236.58	240.14	244.38
55	230.43	233.81	237.83
60	224.33	227.52	231.33
65	218.27	221.29	224.88
70	212.26	215.1	218.48
75	206.29	208.95	212.13
80	200.36	202.86	205.82

Tab.5.1.e.1. Momenti përkulës M_{Ed} dhe lagështia relative RH(%) llogaritur me metodën e shtangësise nominale N.S..




Fig.5.1.e.1. Momenti përkulës M_{Ed} dhe lagështia relative RH(%) llogaritur me metodën e shtangësise nominale N.S.

Konkluzion 5.1.e.

1. Momentet e rendit të dytë të llogaritura me metodën e shtangësisë nominale N.S. zvogëlohen më rritjen e vlerave të lagështisë relative.
2. Përdorimi i çimentos të klasës S në përbërje të betonit sjell rritje të vlerave të momenteve të rendit të dytë sipas N.S. ndërsa përdorimi i çimentos të klasës R zvogëlon momentin e rendit të dytë në elementin në shtypje.

Konkluzion 5.1.

1. Koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ dhe koeficienti efektiv i deforkohës φ_{ef} reduktohet në betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N dhe R përkatësisht.
2. Rritja e lagështisë relative ambjentale RH% sjell zvogëlim të koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ dhe koeficientit efektiv të deformkohës φ_{ef} për betonet me përmbajtje të çimentos të klasave S, N, R.
3. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} rritet për rastin e betonit me përmbajtje çimento e klases R dhe reduktohet për betonet me përmbajtje çimento të klasës S llogaritur me të dy metodat N.S. dhe N.C.
4. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} rritet me rritjen e lagështisë relative RH për të gjitha klasat e çimentos.
5. Vlera e përkulshmërisë limite λ_{lim} llogaritur me metodën N.S. është më e vogël se ajo e llogaritur me metodën N.C.
6. Shtangësia EI llogaritur me metodën N.S. për elementin në shtypje zvogëlohet sipas rendit R, N, S të klasës së çimentos në përbërje të betonit.
7. Momentet e rendit të dytë të llogaritura me metodën e shtangësisë nominale N.S. zvogëlohen më rritjen e vlerave të lagështisë relative.
8. Përdorimi i çimentos të klasës S në përbërje të betonit sjell rritje të vlerave të momenteve të rendit të dytë llogaritur sipas metodës N.S. ndërsa përdorimi i çimentos të klasës R zvogëlon momentin e rendit të dytë në elementët në shtypje.

5.2. Ndikimi i përmasave të seksionit të prerjes tërthore të elementit beton arme në koeficientin e deformkohës dhe tkurrjes së betonit.

Një faktor ndikues në përcaktimin e deformkohës dhe tkurrjes së betonit është raporti i sipërfaqes së seksionit tërthor të elementit me perimetrin e asaj pjese që ekspozohet në ambjentin përreth. Studimi do të përqëndrohet në ndikimin e perimetrit u për tre elementë tip kolonë me siperfaqe të seksionit tërthor të njëjtë. $S=1600\text{mm}^2$.




Fig.5.2. 1. Kolona në shtypje me seksione tërthore dhe armaturë të njëjtë.




Fig. 5.2.2. Pamje e skemës llogaritëse të kolonës sipas dy akseve kryesore y dhe z.

Në llogaritje janë përzgjedhur katër elementët e mësipërm ku sipërfaqja e seksionit tërthor është e barabartë për gjithë elementët $A_b=1600\text{mm}^2$, lartësia, forca normale shtypëse, klasa e betonit dhe kushtet ambjentale janë të njëjta për të katër tipet e kolonave.

Llogaritja do të bëhet për beton të klasës C30/37, klasë ambjentale XC3, shtresa mbrojtëse e kolonave është 40mm. Lagështia relative RH% është e njëjtë për të katër rastet 70%. Betoni ka në përbërje çimento të klasës N. Armatura e çelikut ka sipërfaqe $A_s=2512\text{mm}^2$ me shpërndarje uniforme përgjatë perimetrit. Llogaritjet janë bërë me metodën e shtangësisë nominale N.S.

Ngarkesa N_{Ed} është aplikuar në momentin $t_0=28$ ditë. Forca aksiale është $N_{Ed}=2025(\text{kN})$, lartësia e kolonës është 4m dhe gjatësia efektive është $l_0=2\cdot4=8\text{m}$.

Perimetri i ekspozuar i elementëve tip kolonë ndryshon sipas tabelave me pasojë ndryshimin e sipërfaqes së ekspozuar në ambjentin e jashtëm.

Jane bërë dy llogaritje për secilin tip kolone. Në llogaritjen e parë koeficienti i deformkohës dhe koeficienti efektiv i deformkohës është fiksuar 0 ose elementi është llogaritur sikur të mos ndodhë fenomeni i deformkohës dhe në rastin e dytë koeficienti i deformkohës dhe koeficienti efektiv i deformkohës është marrë në llogaritje me vlerën faktike sipas EC 2. Në secilin rast është llogaritur shtangësia me metodën N.S. që është funksion i deformkohës, momenti përkulës i rendit të dytë, koeficienti i përkulshmërisë limite dhe koeficienti i përkulshmërisë së kolonës.

Referuar llogaritjeve të paraqitura në Tab.5.2.1 dhe Tab.5.2.2 parametrat që do të analizohen janë :

1. Raporti efektiv i deformkohës, φ_{ef} .
2. Koeficienti i deformkohës, $\varphi(\infty, t_0)$
3. Shtangësia e elementit me plasje, EI.
4. Momenti llogarites nga efekti i rendit të dytë , M_{ED} .
5. Përkulshmëria limite, λ_{lim} .
6. Perimetri i elementit të ekspozuar në ambjentin e jashtëm, u.

Deformkoha dhe tkurrja e betonit

Tab.5.2.1.

Metoda	I	I ₀	Kl. cim	N _{ED}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	E _{Iy}	M _{ED}	M _{Edmin}	M ₂	E _{Iz}	φ(∞,t ₀)	U
Kolona 400x400, RH=70%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm											y				z					
	(m)	(m)		(kN)			(m)	(m)			(kN*m)			(kN*m ²)	(kN*m)			(kN*m ²)		
N.S.	4	8	N	2025	69.28	21.79				0	119.2	40.5		21467.73	40.5	40.5		21467.73	0	1600
N.S.	4	8	N	2025	69.28	19.65				1.44	207.3	40.5		17065.51	40.5	40.5		17065.51	1.94	1600
Kolona φ=450, RH=70%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm											y				z					
N.S.	4	8	N	2025	71.11	21.75				0	163.6	40.5		18461.41	40.5	40.5		18461.41	0	1413
N.S.	4	8	N	2025	71.11	19.67				1.42	264.8	40.5		16055.96	40.5	40.5		16055.96	1.92	1413

Tab.5.2.2.

Metoda	I	I ₀	Klasa cim	N _{ED}	λ	λ _{lim}	e ₀	e ₂	1/r	φ _{ef}	M _{Ed}	M _{Edmin}	M ₂	E _{Iy}	M _{ED}	M _{Edmin}	M ₂	E _{Iz}	φ(∞,t ₀)	U
Kolona 300x534, RH=70%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm											y				z					
	(m)	(m)		(kN)			(m)	(m)			(kN*m)			(kN*m ²)	(kN*m)			(kN*m ²)		
N.S.	4	8	N	2025	51.9	28.39				0	40.5	40.5		47270.4	201.16	40.5		17215.12	0	1668
N.S.	4	8	N	2025	51.9	24.17				1.45	40.5	40.5		38351.72	293.84	40.5		15721.02	1.95	1668
Kolona 350x457, RH=70%, Betoni C30/37, Klasa ambientale XC3, shtresa mbrojtëse 40mm											y				z					
N.S.	4	8	N	2025	60.64	23.61				0	40.5	40.5		29135.58	167.48	40.5		18298.59	0	1614
N.S.	4	8	N	2025	60.64	20.87				1.44	40.5	40.5		21171.67	203.74	40.5		17150.5	1.95	1614

5.2.a. Ndikimi i përmasave të elementit prej betoni të armuar në raportin efektiv të deformkohës, φ_{ef} .

Nga Tab.5.2.1. dhe Tab.5.2.2. varësia midis perimetrit u të seksionit dhe raportit efektiv të deformkohës jepet në Tab.5.2.a. e përmbledhur për rastin në shqyrtim.

Elementi	N.S.		
	Përmasat(mm)	Perimetri U(mm)	φ_{ef}
1	$\varphi=450$	1413	1.42
2	400x400	1600	1.44
3	350x457	1614	1.44
4	300x534	1668	1.45

Tab.5.2.a. Varësia midis perimetrit u të seksionit dhe raportit efektiv të deformkohës φ_{ef}

Në tabelën Tab.5.2.a. elementët tip kolonë janë renditur në rendin rritës referuar perimetrit të seksionit tërthor për rrjedhojë edhe sipërfaqja e ekspozuar në ambientin e jashtëm rrethues është renditur në rendin rritës.

Raporti efektiv i deformkohës, φ_{ef} është funksion i raportit A_c/u .

$$\varphi_{ef}=f(A_c/u)$$

$A_c=1600\text{mm}^2 \rightarrow$ është sipërfaqja e prerjes tërthore të elementit, që në rastin në shqyrtim është e njëjtë për elementët 1, 2, 3, 4.

$u \rightarrow$ është perimetri i elementit të ekspozuar në atmosferë.

Konkluzion 5.2.a.

1. Duke analizuar Tab.5.2.a. vërehet se elementi 1 me seksion rrethor që ka sipërfaqen e ekspozuar në ambientin e jashtëm më të vogël gjeneron raportin efektiv të deformkohës, φ_{ef} më të vogël krahasuar me elementët e tjerë.
2. Elementi 4 në të cilin raporti i përmasave h/b është më i madh se elementët e tjerë ka raportin efektiv të deformkohës, φ_{ef} më të madh. Kjo shpjegohet me faktin se sa më e madhe të jetë njëra brinjë e kolonës aq më i ndjeshëm është fenomeni i deformkohës në beton.
3. Elementët 2 dhe 3 ku përmasat e seksionit tërthor janë të barabarta (elementi 2) ose afërsisht të barabarta (elementi 3) gjenerojnë të njëjtin raport efektiv të deformkohës, φ_{ef} .

5.2.b. Ndikimi i përmasave të elementit prej betoni të armuar në koeficientin e deformkohës, $\varphi(\infty, t_0)$

Nga Tab.5.2.1. dhe Tab.5.2.2. varësia midis perimetrit u te seksionit dhe raportit efektiv të deformkohës jepet në Tab.5.2.b. e përmbledhur për rastin në shqyrtim.

Elementi	N.S.		
	Seksioni	U	$\varphi(\infty, t_0)$
1	$\varphi=450$	1413	1.92
2	400x400	1600	1.94
3	350x457	1614	1.95
4	300x534	1668	1.95

Tab.5.2.b. Varësia midis perimetrit u te seksionit dhe koeficientit të deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$.

Koeficienti i deformkohës $\varphi(\infty, t_0)$ është funksion i A_c/u .

$$\varphi(\infty, t_0) = f(A_c/u)$$

A_c → është sipërfaqja e prerjes tërthore të elementit, që në rastin në shqyrtim është e njëjtë për elementët 1, 2, 3, 4.

u → është perimetri i elementit të ekspozuar në atmosferë.

Konkluzion 5.2.b.

